

JAVA
E
MADHE
DHE
E
ESHEJTE

Parathënie

Çë kur sosa Orolojin zura të mendoja të përkthierit e textëvet të Javës së Madhe, po më dukej të kudsoja tepër e kjëndrova shumë mot i ndërdishëm. Si miët si kjasej Java e Madhe më dukë dëtiturë të zëja edhe këtë punë sa të kënakja disa vetë që dishirojën t'e bëja. Nani punën e mbarova e ja parakjit gjithë atireve shpirta të mirë që duan të din që këndojën priftrat te Klisha tek ato ditë te shejte. Kërkova të beja sa më mirë e shpresoj të kem dalë me fakje larë. Ki përkthim, si gjithë t'jerët, ngë ka vlerë zyrtare V.m.th. ngë isht "approvuam" nga të Parët e Klisë.

Prandaj kjëndron edhe ki "përkthim
privat" e si i këtill ka t'jet marrë.

Hora e t'Arbëreshëvet 16 të Nëntorit
të vitit një mijë nëndëkjint e shtatë
dhiëtë e pesë.

Papa Gjergji
Schwartz

D E F T O N J E S

Orthros i të Hënies	f. 2
Projasmena e të Hënies	f. 42
Orthros i të Marties	f.61
Projasmena e të Märties	F. 90
Orthros i të Mërkuries	f.102
Projasmena e të Mërkuries	f.120
Orthros i të Inties	f.127
Esperinoi e Meshë e të Inties	f.155
Orthros i të Prëmties	f.213
Esperinoi , ,	f.303
Orthros i të Shtunies	f.331
Esperinoi , ,	f.387
ORTHROS I TË DIELLIËS	f.457

Η ΜΕΓΑΛΗ

ΕΒΔΟΜΑΣ

JAVA E MADHE

Hora e t'Arbëreshëvet

ΟΡΘΟΣ ΤΗΣ ΜΕΓΑΛΗΣ ΔΕΥΤΕΡΑΣ

MËNGJESORIA E TË HËNIES : MADHE

Bekuar kloft Perëndia i jinë përherë,
nanë e gjithëmonë e për jetë të jetë -
vet . Ashtu kloft.

Lëvdì paçe , o Perëndia i jinë,paçe
lëvdì. Rregji i kjielliës që na përgë-
zon,Shpirti i së vërteties që je gjith-
asajtën e që gjithkjishë mbëlon,vista-
ri i të mirëvet që gjellë dhuron,eja
e rri me ne: pastrona nga çëdò mëkatë
e ruana , o i Mirëth , shpirtrat t'anë.

O i shejti Perëndi, i shejt i fukji-
shëm,i shejt i pavdekshim,lipisi për
ne (3)

Lëvdi past...

Trinë gjithë e shejte,paçe lipisi për
ne;o Zot,ijna afër te nëkatët t'ona;
o i Zot , na ndëjë fajet t'anë .

Eja , o i Shejt,e na shëndosh ligë-

shtin t'ënë paj t'émërit t'it.

Lipisi,lipisi,o Zot,paçe lipisi.

Lëvdì past Ati ... Ati i jinë ...

Pse jotia isht rregjëria e pushte-
tia e lëvdia e t'Jatit,e të Birit e
Shpirtit Shejt....

Shpëtò , o Zot , popullin t'ënt e
bekò trazhginin t'ënt mundie të besë-
mëvet tue dhuruar mbi të mallkuamin
e me krikjien t'ënde ruaj Ti kjëvar-
rin t'ënde .

Lëvdi past ...

O i lartësuar në krikjë tue dashur,
rregjërës së re që ka émërin t'ënt
lipisit t'ote dhuroi Ti,o Krisht Pe-
rëndi. Dëfre me fukjin t'ënde kjive-
rritarët t'anë tue dhënë atireve mun-
die kundra armikjëvet. Paçin ata ndi-
hmön t'ënde,trofé të patundshëm.

nanë ...

O e lëvduashme Mëma e t'in'Zoti,mbu-
ronjë e ndërshme që dreron,mos për-
buz,

o e Mirë, lutiet t'ona. Mfortsò kjëva-
rrit e të krështërëvet, shpëtò ata të
çilëvet Ti i urdhurove të kjëvarrisi-
ën e nga kjiellia atireve dhuroi mun-
dien, pse Ti linde Perëndin, o e vetmia
e Bekuane .

Paçe lipisi për ne , o i Madh'in'Zot,
përsa e madhe isht lipisia jote; na
gjekj të lutemi, paçe lipisi .

Lipisi ,i Madh'in'Zot.

Edhé lutemi për Ipëshkëpin t'ënë e
për gjithë vëllazërin t'ënë në Krisht.

Lipisi, i Madh'in'Zot.

Pse Ti je Perëndi lipisie me njeriun
çë do mirë e na të japiëm lëvdi Tij,
Atit

mbë énerin e t'in'Zoti
bekò , o At.

Z.P. Lëvdi past Trinia e shejte e
njëtëklënëshme e pandarshme nanì e
gjithëmonë e për jetë të jetëvet.
Ashtu kloft.

Lëvdi Perëndis te në i larti kjiell,
pakjie mbi dhet, mirëdashie ndër nje-
rëzit.

Më sbill buzët t'ime e goja jime do
t'rrëfienj lëvdin t'ënde.

Ms. 3. O Perëndi , përçë u bën të
shumë ata çë në helmojën ? Oh, sa janë
ata çë duan të në sulen.

Shumë vetë i thonë shpirtit t'in:
për atë ngë ë shpëtim te Perëndia.

Por Ti je , o Perëndi, mburonjësi
i jim , Ti lëvdia e jime, edhé Ai
çë ngrën lart kriet t'inë.

Me zë të lart vete tue thërritur Pe-
rëndin : nga mali i shejt Ai në gje-
gji.

U u shtura e flëjta : u sgjova se
Perëndia më ruan .

U ngë i trëmbem disa mijërave gjin-
de që rreth rreth do t'inë shtrëngojnë.

Ngreu, o Zot, eja e në shpëtò, Perën -
dia jin; se Ti ja kërsite te fakjia
gjithë atireve që më janë armikjë; të
likjëvet i çajte dhëmbët.

I Perëndis ë shpëtimi; e mbi popullin
t'ënt bekini i jit.

Ms.37. O i Madh'in'Zot, mos më kjërtò
te zëmërimi i jit; mos më mundò te mbë-
ria e jote .

Se shigjetat t'ote m'u ngulën thëllë;
edhë dora jote më shtrëngon ashpër.

Për zëmërimin t'ënt s'ka shëndetë te
mishët t'inë; ngë ë pakjie te eshtrat
t'inë.

Se paligjësit t'ime shkuan sipër kri-
et t'inë; si barrë e rëndë janë të rën-
6.

da mbi mua.

Për lëntsit t'ime plagët më kalben e
më kjelben.

Vuajta kekjë e u kurrusa fort; gjithë
ditën vete tue jetsur në lip.

Se veshiat t'ime u mbushën me sëmun-
dje e ngë ka shëndetë te mishët t'inë.

I përurjur e i tretur shumë kekjë u
jam; nga mundini i zëmëris u ulurinj.

Gjithë dishirimi i jin ë përpara Te-
je e vajtini i jin ngë kjëndron i
fshehur Tij .

U trazua zëmbra jine; më la fukjia;
edhë drita e sivet t'inë ngë ë më me
mua.

Mikjët t'inë e gjitonët më jerdhën
përpara e u mbajtën; kjëndruan prej së
largu të afërmitë t'inë.

E në gjuajën me fukji ata që në kër-
kojnë gjellën t'ime; e ata që duan të
kekjen t'ime thonë kotësira e gjithë
ditën mendojnë si të në gënjejën.

Po u si njeri i shurdhur që ngë gje-
gjen;si i pa-gojë që ngë sbill gojën
e 'tij.

U bëra si njeri që ngë ndëlgon;s'kan
kjërtime te goja jine.

Se tek Ti;o i Madh'in'Zot,u shpreso-
va;Ti do t'në gjegjesh ,Zoti Perëndia
jim.

Se thash:nos u gëzofshin kurr nbi
nua arnikjët t'inë;nos u lëvdofshin
kundra neje,kur të më shkasëshin
kënbët.

Se u jan gati të jem kësitur e të
vuajturit t'inë në ë gjithëmonë për-
para.

Se paligjësën t'ime jam u që e sko-
nollis e do t'në vinjë kekjë për më-
katën t'ine.

Po arnikjët t'inë rrojën e janë të
fortë;edhé u shunësuan ata që në nba-
jën mbëri pa pasur likjë .

Edhé ata që në paguajën të nirën me
të kekjiën në ngalesiën se u kërkonj
të nirën.

Mos më le,o Zot,Perëndia jim,;mos më
më rrish largu.

Anangasu të më ndihësh,o i Madh'in'
Zot,shpëtimi i jim.

Ms.62. O Perëndi,Perëndia jim , u si
sgjonem,prirem tek Ti.

Shpirti i jim ka etë Teje;në dhe i
shkret,i parrugë,i paujë sa të dishi-
ron kurmi i jim .

Prandai të jerdha te shejtoria jote,
sa të shihia fukjin e lëvdin t'ënde.

Pse të kem hirin t'ënt isht më mirë
se sa të rronjë.Buzët t'ime do të të
lëvdojnë.

Kështu përsa rronj u dua të t'bekonjë
Tij e mbë émbrin t'ënt u dua të ngrënj
duart t'ime.

Sikur me paltsë e me dhiamë u mbushë-
shit shpirti jim e goja jime do të
këndonjë me buzë në gaz.

U dua të t'kujtonj kur të bie në sh-
trat; që kur bën ndritqullë,dua të men-
donjë Tij .

Pse Ti je ndihma jime;nën pështrimit
e krahëvet t'atë do t'rronjë i gëzuan.

Shpirti jim u ngjit pas Teje;e drej-
ta jote më mban.

Ata më kot kanë kërkuar shpirtin
t'im;ka t'sdripen përposh dheut;
ka t'jenë dhënë te duart e shpatës;
do t'bënen pjesë për dhelprat.

Po rregji do t'gëzonet te Perëndia
e kush do t'bënjë bë mbi Atë,ka të
lëvdonet,se goja e atireve që flasiën
gënjeshtra do t'jet mbillurë.

Ms.0 Zot,Perëndi i shpëtimit t'im,natë
87e ditë të kam thërritur.

Jarshit përpara Teje lutia jime;
mirr 'veshë parkalesin t'ime.

Se shpirti i jim isht mbushur me të
kekjia e gjella jime kjaset varrit.

Jam i nëmëruar ndër ata që jan'e
i sdripiën te gropa;u bëra si një nje-
rri që ngë mënd't'jet më ndihmë,i lënë
si i vdekur.

Në mes t'atireve që flën te varret,
të të çilëvet Ti ngë ke më kujdës,të
larguarë nga dora jote.

Më vun te një gropë shum'e humbëtë
e te t'në t'errëtitë e te hjëja e mor-
ties.

Zëmërimi jit kjëndroi mbi mua e gji-
thë valët u shklakuan mbi mua.

Ata që më njihiën më i largove;
më përbuziën si një kalbësirë.

Kleva mbillur e ngë mënd't'danjë;
sit t'inë u sëmuren nga mjerimi jim.

U gjithë ditën të kam thërritur Tij;
tek Ti kam ndejtur duart t'ime.

Omse do t'bësh famasmë ndër të vdeku-
ritë;dot t'ngrëhen ata e do të t'lëv-
dojën?

Kush do të rrëfienj te varri lipisin
t'ënde e vërtetën t'ënde në prishie?

Do t'jenë njohurë famasmët t'ote te

TË MË T'ERRËTITË e drejtësia jote në
dhe të harruam?

Po u Tij të thërrija e që në mëngjes
do t'ngrehet lutia jime tek Ti.

Përsé, o i Madh'in'Zot, shpirti jin të
veli e Ti prier fakjien t'ënde prej
meje ?

I vapëk jam u e në mjeri që fëmijë;
kërkoni të ngrëhem e jam shtur posht
i sosur.

Zëmërimet t'atë shkuan mbi mua; kjër-
timet t'atë më dreruan.

Më rrethuan si ujëra; ditën e tërë
gjithë më kjarkojën.

Largove prej meje qëdo mik e gjiton;
ata që më njihiën në lan për njerimin
t'in.

Ms.102. Bekò, o shpirti jin, t'ën'Zonë;
të gjitha brënda mua të bekojën émbrin
e 'Tij të shejt!
12.

Bekò, o shpirti jin, t'ën'Zonë e mos
harrò mirëbëmat e 'Tij.

Ai të ndëjën gjithë ftesat t'ote;
Ai të shëndosh gjithë sëmundet t'ote.

Ai të liron nga prishia gjellën t'ën-
de; Ai të ngjesh me një kurorë lipisish
e ndjësësh.

Ai të nglin me të mira dëshirin t'ënt;
do t'përtërihet djelmëria jote si
ajo e shkjipes.

In'Zot bën mëshirë e ligjë gjithë a-
tireve që janë të shkelurë.

Ai desh të dëftpj Moiseut udhët e
'Tija e të bijëvet e Israelit thagnëtò
e 'Tija.

In'Zot isht i dhënbëshëm e i kjelmë-
riseshin, zëmërë gjerë e i lipisis.

Nuk zëmëronet përherë, as mban mbëri
gjithënonë.

Nuk bëri neve pas mëkatshit t'ona,

as na ndëshkoi pas fajeshit t'anë.

Pse sa isht i lart kjielli mbi dheun,
akjë e nëndëme bë in'Zot lipisin e
'Tij mbi ata që i trëmben.

Sa isht lark të dalit e diellit nga
të perënduarit, akjë bë të rreshten
largë nesh nëkatët t'ona.

Si një at ka lipisi për të bijët;
ashtu ka in'Zot lipisi për ata që i
trëmben.

Se Ai vet njuh si na klenë bër;
Ai kujtonet se na jemi plëh.

Njeriu: si bari janë ditët e 'tija;
e si lulëja e fushës, ashtu endet.

Se në shkon mbi atë një frinë, ai
nuk isht më; edhe ngë njihet më ven-
di ku ishë.

Por lipisia e t'in'Zoti që noti nde-
net motë monë mbi ata që i trëmben.

14.

E drejtëria e 'tij mbi të bijët e të
bijëvet që ruajën dhiatë e 'tij e që
kujtonen mbi urdhurimet e 'tij sa t'i
nbarojën.

In'Zot vë në kjiell thronin e 'tij,
e rregjëria e 'tij zotëron gjithëkund.

Bekoni t'ën'Zonë ju të gjithë; o ën-
gjij e 'Tij, tue gjegjur zërin e fia-
lëvet e 'Tija.

Bekoni t'ën'Zonë ju të gjitha ushëri
të 'tija; ju diakër të 'Tij që bëni
dashien e 'Tij.

Ms.142. O Zot, gjekj parkalesin t'ine;
mirr 'veshë lutien t'ine paj të vër-
teties s'ate; gjegjëmë paj të drejtësis
s'ate.

E mos hir në gjikjë ne shërbëtorin
t'ënt, se mosnjeri ndër të gjallitë
isht i drejt përpara Teje.

Se armiku ka ndjekur shpirtin t'in e
ka shtur posht njera te dheu gjellën
t'ine.

Më vuri të rri ndër t'errëtitë si të

vdekurit e vjetrë e shpirti jin isht
në helm, e brënda meje isht e trazuame
zëmbra jime.

U kam kujtuar ditët e motçme; kam
nejtuar nbi gjithë veprat t'ote tue
menduar të bëmat e duarëvet t'ote.

U ndenj tek Ti duart t'ine; shpirti
jin isht si një dhe i that.

Shpejt gjegjënë, o Zot. M'u nuar shpi-
rti!

Mos prir fakjien t'ënde ngak u e u
nos. t'i glas atireve që sdripen në gro-
pë.

Bëjënë të gjegjem që menatnet lipisin
t'ënde, se tek Ti kam ^{pasur} shpresë.

Bëjënë të njoh, o Zot, dhronin tek i
çili u kam të jets, se tek Ti u kam
ngrëjtur shpirtin t'in.

Lironë nga arnikjët e mi, o Zot, tek
Ti kam gjetur pështrin. Mësonë të bë-
një vullinin t'ënt, se Ti je Perëndia
jin.

Shpirti i jit ka t'në hélkjënjë te
dhroni i drejt paj t'ëmbrit t'ënt, o
Zot; Ti do t'në japësh gjellë.

Me drejtësin t'ënde Ti ndsir shpirtin
t'in nga ngushtimet, e ne lipisin
sos arnikjët e ni.

E prish gjithë ata që në shtrëngojnë
shpirtin t'in, se u jam shërbëtori jit.

ë pameta

Gjegjëmë, o Zot, te drejtëria jote,
e nos t'hish në gjikjë ne shërbëtorin
t'ënt. (2)

Shpirti i jit i mirë ka t'në hélkjë-
një te dhroni i drejt.

Lëvdì past Ati ...aliluja (3)
lëvdì Tij, o Perëndì (3) shpresa e
gjithë neve, paçe lëvdì.

*pas Litanis s'madhe (e para e meshës)
këndonet:*

Që nga nata ë prierrë tek
Ti, o Perëndì, shpirti jin, se urdhuri-
net t'atë janë dritë nbi Dhet.

aliluja (3)

17.

O ju që jeni nbi Dhet, mësoni drejtësin. aliluja (3)

Mberia jine do t'mundonjë popullin të pasuellshëm e nanë ziarri prish arnikjët t'inë. aliluja (3)

Shtoi të kekjie, o Zot, shtoi të kekjia të lëvduashmëvet e jetës. aliluja (3)

Ἰδοὺ ὁ Νυμφίος ...

Shi' se vien Dhëndërri në nes të natës; e i lun shërbëtori, të çilin Ai e gjen sgjuar; po mjeri ai të çilin do t'e gjenjë të kjëlluan. Ruaj pran, o shpirti jin, nos mundesh gjunit, sa nos t'jesh dhënë vdekjies, e nos të kjëndrosh mbëllin jashta rregjërës; po .
sgjou take thirrur: ishejt, i shejt, i shejt je, o Perëndi. Për Mënën t'ëndë kijna lipisì. (3)

Τὰ πάθη τὰ σεπτὰ ... ἤχος 2'

Pesimet t'shejtë si dritë shëndetie ndritiën sot nbi jetën: pse Krishti paj se ishtë i mirë, kjaset të vuanjë. Ai që te dora e 'tij nban jetën e tërë lëhet t'jet vjerrë nbi drurin sa të shpëtonjë njeriun.

Ἀόρατε Κριτά, ... ἤχος 2'

O gjikëtar i padukëshëm, si u dëftove në kurn? E si vien t'jesh vrrar nga të paligjët e kështu me vuajtiet t'ote dënon dëninin t'ënë. Prandai gjithë një zë këndojmë, madhërojëm, lëvdojmë, o Fialë, pushtetin t'ënt.

Τῶν παθῶν τοῦ Κυρίου ... ἤχος 2' 8'

Këjë ditë e sotme bën dritë nbi të zënit fill e pesimevet të t'in'Zoti.

Ejani andai të besmë, le t'nbëjidheni bashkë tue kënduar. Krionjësi ishtë e vien sa t'narrënjë krikjien, të ket gjikjë e të rrahur i gjikuar nga Pilati, i narrë me shplaka nga një shërbëtuar pranon gjithkjishë sa të shpëtonjë njeriun.

ishtë hera e Vangjejit Pnifti thot:

E sa t'jeni bër të mirë të gjegjeni Vangjejin shejt i luteni Perëndis t'ënë. Kjirie eloison (3)

Vangjeji si shkruan shën Mateu
XXI,18-43

Tek ai kjërò Iisui ish'e prirej në
kjitet e ndiejti urì.19.E të parit
një kënbë fiku mbi dhromin,vate mbë
atë e ngë gjeti tek ai t'jatër se fle-
të vetën e i tha atij: let mos lehet
në penë tek ti për gjithëmonë e fiku
u tha gjithënjëibashku. 20. E si e pan
dsënësit u famasën e thoshiën:si u tha
gjithënjëibashku! 21. E Iisui ju për-
gjekj e i tha atire:ne të vërtetë ju
e thon:se në ju paçit besën e nos sku-
dsoshit,ka të bëni jo vetën të fikut,
po edhe në i thëfshit këtij mali:ngre-
u shtieu te dejti,ka t'jet.
22.E gjithë ato shërbise çëdo lipëni
te parkalesia,në kini besë,ka t'i ki-
ni.23. E kur jerdhi te faltoria,si i-
sh'e nësoj,ju kjasën të parët e prif-
travet e plekjët e popullit tue thë-
në:ne çë fare pushtet ti bën këto shë-
rbise? E kush të ka dhënë këtë push-

tet?24. E Iisui ju përgjekj e i tha ati-
reve: kan edhe U t'ju pënj një fialë,
çë në ju n'e thëfshit,dua të ju thon
ne çilin pushtet U bënë këto shërbise.
25.Pagëzini i Janit ngaha vij?nga kji-
ellia a nga njerëzit? E ata vejën tue
folë ndër 'ta e thoshiën:26.Në thëf-
shim nga kjiellia,do t'na thot Aì:e
përcë andai ngë e patët besë? Në pra
i thëfshin,nga njerëzit,i trëmbeni
gjindes,se gjithë kanë Janin si Profet.
27. E u përgjegjën e i thanë Iisuit:
ngë e din. I tha atireve edhe Aì: As
U ju thon juve ne t'çilin pushtet U
bënë këto shërbise.
28.Si ju duket juve? Një njeri kishë
di bij,e ju kjas të parit e i tha:
ti,diali jin,jets e shërbë so te vre-
shta jine. 29. Aì u përgjekj e i tha:
ngë dua;po ndërroi vullin e vata.
30. E të kjasurit tek i dijti,i tha
edhe atij ashtu. Po ki u përgjekj e
i tha:jan e vete,zot,po ngë vate.

31. Kush nga këta di bë vullinin e të jatit? I thonë atij:i pari. I thot atireve Iisui: me të vërtetë ju e thon,se voishtarët e kurvat venë përpara jush te rregjëria e Perëndis.

32.Posa Jani jerdhi tek ju në dhrom të drejtëris e ju ngë e patët besë:e ju që pat këtë,ngë ndërruat pra vullin, sa t'e kishët besë.

33.Gjegjij nj'atrë parabullë:ishë një njeri i zot shpie,i çili vuri bjë vreshtë e rroth asaj i vu një garth e atie grënoi e i vuri një linua edhe i stisi një turrë e vreshtën ja dha bulkjëve e vate andi dherash. 34. Kur pra u kjas kjëroi i penëvet,i zoti dërgoi kopijët e 'tij te bulkjit,sa të mirriën penët e vreshtës.

35.E bulkjit zun shërbëtorët e 'tij e kë rrahën,kë vran e kë kjëlluan ne gurë.36. Përsëri dërgoi t'jerë kopij, e në shunë se të parët e i bën atireve ashtu si të parëvet.

22.

37. Ndë vonë i dërgoi atire të birin e 'tij,pse thëshëj:t'in biri do t'i ken nbarrie. 38.Po bulkjit si pan të birin, thanë ndër 'ta:ki isht rredha;ejani, vrasnie e nbajën na pethkun që i nget atij.39. E e zun,e ndsuarën jashta vreshtës dhe e vran.40.Kur andai të vinjë i zoti i vreshtës,që ka t'i bënë atireve bulkjë? 41. I thonë ata: këta të kekjë ka t'i sosënjë ne të kekjë e vreshtën ka t'ja truanjë t'jerë bulkjëve,të çilët ka t'i japiën penët te kjëroi i 'tire. 42. I thot atire Iisui:ngë kini sgledhur kurr te të Shkruamet!atë gur që shtun nbë nj'anë ata që stisiën,ki u bë krie angonie"? Këjo u bë nga in'Zot e isht e fanasë shne përpara sivet t'anë!" 43. Prandai U ju thom juve se do t'jet narrë ngak ju rregjëria e Perëndis e do t'jet dhënë gjindes që bëjën penët e 'tire.

1032 501 KUPJE

Ms. 50. Lipisi për mua paçe,o Perëndi, përse e nadhe isht butësia jote;e për sa të shunë janë nëshiret t'atë:Ti fshij të paligjen t'ine.

23.

Po tërë në laj së paligjet s'ine, e
në dëlir nëkatiot s'ine.

Pse u e njoh të paligjen t'ine, e në-
kata jine po në ë kundra, përherë nua
përpara.

Kundra Tij vetën u nëkatrova e përpa-
ra fakjies s'ate u bëra të kekjien, sa
të daljsh i dërejti ne fialët t'ote e
sa të mundësh kur të jesh gjikuarë.

Se shih se ndë të paligjet u u leva
edhé ndë nëkatë nua në zu nëna. jine.

Se shih se Ti deshe të vërtetien: Ti
nua në sbëlove t'ershmatë e të fshehu-
ratë e urtësis s'ate.

Ti në shtërpik ne isopin e u kan të
dëliren: të në lash e u në se bora do
t'jen sbardhurë.

Bën të gjegjen fialë gëzini e hareje
e të përunjëtë eshtrat t'inë kanë të
gëzonen.

Fshihe Ti fakjen t'ënde nëkatëshit
s'ine e fshiji të gjithë të paligjet
t'ine.

Më bën, o Perëndi, një zënërë të dëlirë
ndë nua e shpirt të dërejti në përtërij
brënda nua .

Mos në përözj nga fakjësja jote e nos
hilkj neje Shpirtin t'ënt të shejt.

M'u kthoftë hareja e shëndeties s'ate,
e në mbafshe fort ne shpirt së larti
udhëtar.

Dua t'i nësonj udhëtë t'ote të pali-
gjëvet, e kekjbërësit kanë të prirënë
tek Ti.

Shpëtonë nëkatëshit gjaku, o Perëndi,
Perëndia i shëndeties s'ine: gluha ine
ka të lëvdonjë ne gëzin dërejterin
t'ënde.

O Zot, në sbyll buzëtë t'ine, e goja
ine ka të rrëfienjë lëvdin t'ënde.

Përsë në dashur kishe flijë, u t'e
kishia dhënë, por Ti nuk kënakje ne
olokuste.

Flijë Perëndis isht një shpirt i gri-
jtur tue dhëmbur: një zënërë të prerë
edhé të përunjurë Perëndia nuk e di-
shpëlkjën.

Klofshe i nirë, o Perëndi, ne Sionin
te pëlqjini jít: e të stisen muret e
Jerusalinit!

Ashtu atë herë do t'narrsh ne-hir
flijën e dërojtëris, dhuratatë, olokaus-
tet.

Aherë kanë të të bien viçëra therores
s'ate.

TRIODHII ODHA e I *ἤχος β'*

Τῷ τῆν ἄβατον ...

Le t'këndojën t'in'Zoti që ne të hji-
nushën urdhurin teri dejtin të tërbuan
që ngë nënd't'shkonej e udhëhëkjji në-
përnes në kënbë popullin e Israelit,
pse ne lövdì Ai u lövdërua.

Ἡ ἀπόρρητος Λόγος ...

Të pathënëshnit të sdripur të Fialës
Perëndi! Ndë të marrit fitirën e shër-
bëtorit Ai i dëfton dsënësëvet se për
Atë ngë ë një të vjedhur t'jet Perëndi.
Vërtetani ndë lövdì Ai u lövdërua!

Διακονῆσαι ...

U vet Krionjësi jerdha të shërbeja
Adhanin të t'çilit u desha të vishia
fitirën. U si Perëndi i kjosën e që
s'nëndë të vuanjë, jerdha të jipia gje-
llën t'ine për shpërblin t'Adhanit i
vapëk.

pas eti kje eti...oti agathòs...
sglidhet kondakji 'O 'Ιανώβ ὠδύρετο;...

Jakovi e klaj se e kishë sbierrë e
fisniku ujej nbi një thron i nderuar
si rrekjë. Se ngë shërbeu pëlqjinevet
e Egjiptianës kle lövduar nga Ai që
vërrën zënprat e njerëzëvet e jep ku-
rorën të paprishëshne.

Përziejën vajtinin t'ënë ne vajti-
nin e 'tij; tue u rrahur përziejën lo-
tët t'ona ne ato të Jakobit që kla
nbi të urtin Josef. Se ai nbigjithëse
shërbëtuat në kurnin, ruajti shpirtin të
lirë e u bë i zoti i tërë Egjiptit. 27.

Pse in'Zot jep shërbëtorëvet të 'Tij
një kurorë të paprishëshme.

TEK E HËNIA E SHEJTE DHE E MADHE PËR-
MENDIËM TË LUMIN E BUJARIN JOSEF
E EDHE FIKUN që u ter ne mal-
lkinin e t'in'Zoti.

I urti Josef u dëftua një kji-verri-
tar i drejt e dhuronjës drithi.
Oh, grumbull të mirash!

Te fiku in'Zot sheh Sinagogën e
mbrazëtë, pa penë shpirtullore,
dhe e ter ne mallkinin e 'tij.

Le t'jikiën na nga i njëllojti
fat.

Paj të lutievët të Bujarit Josef, o
Krisht Perëndi, kijna lipisë.

ODHA e VIII

"Εφριξε παιδων...

Kurni i pastër - sa shpirti i 'tire-
i djenëvet bujarë u shkunt e u shtu
28.

prapa përpara zjarrit të pushuashën i
ushkjiën nga lëndë pa të sosur.

Po kur flaka gjithëmonë e gjallë zu
të shuhej u ndie këndini i të pavdek-
shnit himn: O ju gjithë veprat e t'inë
Zoti këndonin e lartësonin t'en'Zonë për
gjithëmonë.

'Υμᾶς μου τότε μαθητὰς...

Juve, se kletë dsënësë t'inë, ka të ju
njohiën gjithë, në ruani urdhurimet
t'inë, thot Shpëtuesi nikjëvet, si kja-
set të vuanjë. Rrini në pakje ndër
jush e ne gjithë. Tue menduar të
ujtë, do t'jini ngrëjtur lart e tue në
njohur si i Zot, lëvdoni e lartësoni
Mua për gjithëmonë.

Τάξεως ἔμπαλιν ...

Pushteti i jin ndër jush nos kloft
si ai i gjindarëvet. Ngë ë shërbes ji-
ni tirania, po mendini i lirë. Kush
do t'jet i pari ndër jush, kloft i

sprasni i gjithëve e tue në njohur si
i Zot, lëvdonni e lartësonni për gjithë
nonë.

Τὴν Θεοτόκον... Mënën e Perëndis
e të Dritës tue nderuar ne hinne, na-
dhërojën !

ODHA e IX.

Ἐμεγάλυνας, Χριστέ ...

Ti, o Krisht, ke nadhëruar Mënën e Pe-
rëndis që të lindi. Nga ajo Krionjësi
i jinë kle veshur ne një kurn që vuan
si jini. Kështu na liroi nga paditurit
t'ona. Tue lumëruar Atë gjithë jinit,
Të nadhërojën Tij .

Ῥύπον πάντα ...

Tue u liruar nga çëdo ngjolle épshesh
paçit mendine të urtë, të mirë për rre-
gjërin e kjielliavet tek e çila do t'
kini lëvdë e të lambarisni në të shkël-
kjenë së dielli, i thoshie Ti, o Dieja
e gjithësis, Apostojvet t'atë.
30.

Ἀφορῶντες εἰς ἐμέ...

Tue në vërrejtur mua, the, o i Madhi
in'Zot, Apostojvet t'atë: nos mendoni
gjëra të larta, po të jini të narrë nga
të ultat. Pini kjelkjin që U pi pse
te rregjëria e Tatës bashkë ne Mua do
t'kini lëvdë.

pas eti... ὅτι σε ἐνύσι... τὸν νυμφῶνα...

Nusëroren t'ënde shoh, Shpëtuaes, të
stolisurë; po të veshurën u s'kan
sa të hinjë tek ajo. Ndritësonë pra
stolën e shpirtit, Dritëdhënës e
shpëtonë. (3)

E N I

Çëdò frinë le t'lëvdonjë t'ën'Zonë!

Ms. 148. Lëvdoni t'ën'Zonë nga kjielli-
at; lëvdonie nga në i larti kjiell;
Tij të nget lëvdia, o Perëndi!

Lëvdonie gjithë ëngjëjitë e 'Tij, lë-
donie gjithë fukjët e 'tija.

Lëvdonie dielli e hënza; lëvdonie
gjithë ijëzit e drita.

Lëvdonie kjiellia e kjielliavet e uj-
ëra sipër kjielliavet.

Le t'lëvdojën énbrin e t'in'Zoti, se A
Aì foli e ata u bën. Aì urdhuroi e ata
klenë stisurë.

I vuri për jetë e për jetë të jetëvet.
Urdhuroi e ki urdhurin ngë ka të shko-
një.

Lëvdoni t'ën'Zonë nga dheu; ju bishat
e dejtiti e ju hone të gjithë.

Zjarr, breshërë, sborë, akull, erë e fur-
turës çë nbaron fialën e 'Tij.

Male e ju gjithë kodra, drunje penie
e gjithë dëllinjat.

Shtaza të egëra e çëdë bagëti, shtë-
pinjë e zoga çë fluturojnë.

Rregjëra të dheut e gjithë popujitë:
të Parët e gjithë gjikëtarët të dheut.

Djelnotrat e virgjërat, plekjtë ne të
rit le t'lëvdojën énbrin e t'in'Zoti,
se u lartësua énbri i 'Tij të vetën.

Kloft lëvduar nbi kjiell e nbi dhe
Aì çë jep fukjll popullit e 'tij.

Lëvdì paçin shejtrat e 'Tij, të bijët
e Israelit, populli i sgledhuri i 'tij.

Ms. 149. Këndoni t'in'Zoti një këndin;
kloft Aì lëvduar te nbledhia e shejtra-
vet.

Le t'gëzonet Israeli nbi Atë çë e bë-
ri e bijët e Sionit le t'gëzonen nbi
rregjin 'tire.

Le t'këndojën énbrin e 'Tij ne vallë;
le t'e nsaliën ne timpan e ne nsaltir.

Se in'Zot gëzonet ne popullin e 'tij:
Aì do t'lartësonjë të butitë në shpë-
tin.

Do t'nburren shejtrat në lëvdì; do
t'gëzonen te shtretat e 'tire.

Goja e 'tire lartëson t'ën'Zonë;
te duart e 'tire shpatë ne di presie.

Sa t'narriën shpagin ndër kombëvet;
të kjërtojën popujitë.

Sa të lidhiën rregjërat e 'tire e
bujarët e 'tire ne hekure.

Sa t'nbarojën ndë 'ta dëninin të
vendosur.

Këjò lëvdì i nget gjithë shejtravet
e 'Tij.

Ms.150. Lëvdoni Perëndin te shejtrat
e 'Tij;lëvdonie te hapësira të fukjës
s'Tij.

Lëvdoni t'ën'Zonë për fanasnët e 'tij;
lëvdonie për sa i math isht Ai.

Lëvdonie ne zë trumbetie;lëvdonie
ne nsaltirin e kjitharën.

Lëvdonie netinpan e ne vallë;
lëvdonie ne lahutë e ne organ.

Ἐρχόμενος ὁ Κύριος ...

ἦχος α'

Si in'Zot ne-hir vej t'ishë munduar
i thoshëj Apostojvet për dhron:Nanì
ngjipeni Jerusalin e i Biri i njeriut
ka t'jet dorëzuar si ë shkruar nbi Atë.

Ejani andai e pësiellnie ne mendine
të pastrë e le t'na vën ngrikjë ne Atë
e për Atë të vdesiën pëlkjinevet e gje-
llës,sa të rrojën ne atë e t'e gjegje-
ni të thërresënjë: Jan e vete nanì jo
në Jerusalinin e dheut sa të vuanjë,po
34.

hipen te Ati jin e Ati i jij,te Perën-
dia i jin e Perëndia i jij. E do t'ju
hip ne Mua te Jerusalinin i sipërn,te
rregjëria e kjielliavet.

Θεόσαντες πιστοί ... ἦχος π) α'

Nanì që arrun te ditët e Pesinevet
shpëtonjëjë të Krishtit Perëndi,japiën
lëvdì,o të besnë,të pathënëshnes zë-
nërëmadhëris e 'Tij sa Ai,paj të nëshi-
rit t'tij të na ngjallënjë edhe neve
të vdekurë te nëkata si i Mirë e Nje-
ridashës.

Dhoksa ... Κύριε,ερχόμενος... ἦχος π)

O i madh'in'Zot,si kjaseshe Pesinevet
t'atë,Ti,sa t'jipie zënërë dsënësëvet
t'atë,si i more në nj'anë,i thoshie:
"si harruat fialët që u një kjërë ju
thëshia se ë shkruar se mosnjeri nga
Profetrat ngë ka t'vdesënjë jashta
Jerusalinit"? Nanì arruri hora që ju
thash juve :shi' nanì jan'e në japiën
te duart e t'nëkatruanëvet sa t'jen 35.

i përkjeshur e ka t'në vënë ngrikjë,
ka t'në vënë te varri e të në narriën
për një i vdekur i urrejtur.

Po mirni zënörë:mbi tri ditë do të
ngrëhen për gëzinin e të besnëvet e
gjellën e pasosne.

SI DHOKSA PREPI ... Tij të nget lëv-
dia, o Zoti Perëndia jinë e na të japi-
ën lëvdin Tij Atit, Birit e shpirtit
Shejt, nanë e gjithëmonë për jetë të
jetëvet, anin.

Lëvdi në të lartitë Perëndis e mbi
dhe pakjie dhe ndër njerëzit vullnësë
e mirë.

Innojën Tij, të bekojën Tij, të përnise-
mi Tij, lavdërojën Tij, të falnderojën
Tij për lëvdin t'ënde të nadhe.

O Zot Mbret i kjiellit Perëndi Ati i
gjithënëndëshin, o Zot Bir i vetëm Iisu
Krishti edhe Shpirti i Shejt.

O Zot, Kjenkji i Perëndis, i Atit Bir,
çë ndsier nëkatën e jetës, lipisi për
ne, o Ti çë ndsier nëkatët e jetës.

Përit mirë lutien t'ënë Ti çë rri u-
jur tek e drejta e Atit e kijna lipi-
si.

Se Ti vetëm je i shejt, Ti vetëm je
Zot, Iisu Krishti në lëvdi të Perën-
dis Atit, ashtu kloft.

Ditë për ditë do t'bekonj Tij, do të
lavdëronj ëmbrin t'ënt për jetë e
në jetë të jetës.

O Zot, Ti pështrin ke klënë për ne
brez pas brezi. U thash: o Zot, lipisi
për mua: shëndoshëni shpirtin se për-
para Teje nëkatrova.

O Zot, tek Ti u kanë gjetur pështrin:
nësonë të bënë vullnin t'ënt, se Ti
je Perëndia jin.

Se tek Ti isht burini i gjellës;
te drita jote do t' shohiën na dritë.

Sgjerò lipisin t"ënde mbi ata që të njohiën.

Bën-na të mirë, o Zot, të ruheni na të pa nëkatë.

I bekuar je , o Zot , Perëndia i atë-ravet t'anë, dhe enbri i jiti isht i kënduar e i lavdëruar në jetë të jetëvet; ashtu kloft.

Kloft, o Zot, lipisia jote mbi ne ashtu si keni shpresuar tek Ti.

I bekuar je, o Zot, nësonë Ti të drejtat t'ote;

I bekuar je, o i Zot, le t'ndëlgonjë u të drejtat t'ote.

I bekuar je, o i shejt, ndritëmë ne të drejtat t'ote.

O Zot, lipisia jote ë për gjithëmonë; veprat e duarëvet t'ote Ti nos për buz.

Tij të ngët nderimi, hymni e lëvdia Atit e Birit e Shpirtit Shejt nani...
38.

P l i r o s o n e n òti eléus...

Irini pasi Tas kjefalas

Priëti thot këtë lutie mistikisht:

O Zot i shejt, Ti jës te në i larti kjiell e ruan të përunjtitë.

Tij, i çili ne siun t'ënt që vëshgon gjithkëjsh vë re gjithë kriesës, na të keni përurur e shpirtin e kurmin e të parkalesiën: o Shejt i shejtravet, ndë dorën t'ënde të padukësh-ne nga ndenja jote e bekona gjithë neve. E që dë nëkatë që nënd't'keni bër, si i Mirë e Njeridashës, ndëjé tue na falur neve të mirat e jetës si atë të nbinaturshne.

Se jiti ë të pasurit lipisi e të shpëtuarit neve e na të japiën lëvdi Tij Atit.....'

A P O S T I H A

Κύριε, πρὸς τὸ μυστήριον... ἡχος πλ. α'

E jëna e të bijëvet t'Zebedheut, po-sa ngë nënd't'ndëlgoj misterin të pathënëshën e ikononis t'ënde, të lipëj
39.

pëj për të bijtë e 'saj nderin e njëi
rregjerie e përkohëshme. Po Ti në vend
të këtij i takse nikjüvet t'atë të pij-
ën një kjelkjë vdekje që Ti në para
se ata ki't'pije Ti vet si Lirues i në-
katövet. Prandaj të thërresion: O Shpë-
tues i shpirtravet t'anë, paqe lëvdë!

Ms. që në mëngjes jeni mbushurë me lipë
89, pisin t'ëndë, o i Madh'in'Zot, akjë
... të gëzoneni e të bëjnë harë gjithë
ditët t'ona...

Κύριε, τὰ τελεώτατα φρονεῖν... η'χος π'δ'

Tue i nësuar dsënösëvet t'atë të ki-
shën mendine të përsosurë e nos t'i
glisiën gjindarëvet te të zotëruarit
nbi të vogjité, i thëshie: Mos kloft
kështu ndër jush, dsënösit t'inë, pse U
vet desha t'isha i vapëk. I pari andaj
ndër jush le t'i shërbenjë gjithëve.

Ai që urdhuron skurse isht urdhuruar
e i sgledhuri si i sprasëni. U vet je-
rdha t'i shërbeja. Adhanit i vapëksuar
e të jipështa si shpërblin për shumë ve-
të që në këndojnë: lëvdë Tij.

ms. 89, 17. E shkëlqjëft lëvdia e t'inë
Zoti Perëndis t'önë nbi ne . Ti ndre-
kjë për të mirën t'önë të bënat e du-
arëvet t'ona; udhëhëkjë Ti punën e du-
arëvet t'ona.

Τῆς ζηραυθείσης... η'χος π'δ'

Tue u trëmbur të keni ndeshkinin e
fikut i tertur pse ngë bëj penë, le
të bien na penë të vëjëfshme pendi-
ni Krishtit i çili neve na dhuron
të madhen lipisi.

Dhoksa..kje nin ... Δευτέραν Εύαν...

I nallkuani ndëlgoi se gjeti te
Egjiptania një Evë të dijtë që me
fialët e 'saj e lajka ki't'bëj të
bij Josefin . Po Josefi la rrobikun,
jiku nga nëkata e ngë u turpërua se u
ndoth nilikurë si i pari njeri në
para se t'nos mirrëj 'veshë.

Për lutjet e 'tij, o Krisht, kijna li-
pisi.

Agathën to eksonolojisthe...

Bukur isht të lëvdojnë...

T r i s a j i e kondakjii v.f.27.

a p o l i s i s

In'Zot që deshi të vij të vuaj për
shëndetën t'ënë, Krishti Perëndia jinë
paj të Povirgjërës e shë Mëri.....

E S P E R I N O I i të MARTIES S'MADHE

(të Hënë menatë me
Projasmenën)

te Kjirie ekjekraks këndimet janë pa-
ta ata të Mengjesores

P r o f e t s i t

Ms.127. Të bekoft i Madh'in'Zot
nga Sioni, Ai që bëri kjiellin e
dheun.

Nga libri i "TË DALIT" I, 1-20.

Këta janë émbret e t'bijëvet e Israe-
lit që jerdhën në Egjipt me t'jatin e
'tjere Jakobin. Çunjëri jerdhi me shpin
e 'tij. Ruvin, Sincòn, Levì, Judhas, Isa-
har, Zavulòn, Venianin, Dhan, Nefthalin,
Ghadh e Asir. Josefi ndodhej sa ka në
Egjipt.

Gjithë të pasardhësit e Jakobit
ishën shtatëdhietë e pesë.

Vdikjë pra Josefi e gjithë vëllëzë-
ritë e 'tij e gjithë ajo jini.

Po bijët e Israelit u rritën e u
shuësuan e u bënë buria e akjë shunë
të fortë se mbëluan dheun e Egjiptit.

Ndërkakjë vien nbi Egjiptin një rre-
kjë i ri që ngë kishë njohur Josefin
e i thot gjindes s 'tij:shi'se konbi
i të bijëvet e Israelit u ka bër i
nath shunë e na vohet sipër. Vërre-
jën që ka t'bëjën sa t'e nbajën për-
posh neve nos të rritet në shunë e
të vuhet me amnikjët t'anë, në vien
ndo luftë e të luftonjë kundra nesh
e të lönjë Egjiptin. E kështu te
shërbëtirët i vu sipër atireve gjin-
de që t'i bëjën të shërbejën rëndë.

E ata stisën për Faraonin kjitete
forteze Pithò, Ramessi e On që isht
Iliupoli. Po me shunë i vujën posht

në shumë ata rriteshën e bëneshën të fortë. E Egjiptianët ishën urrejtur nga të bijët e Israelit. E Egjiptianët zotërojën të bijët e Israelit me egërsi e idhnojën gjellën e 'tire në shërbëtorë të rënda të përgatitur rit këlkjeren e pllaka e të çodë punë e rëndë përjashta, gjithë punë të çilat i shtrëngojnë të bëjnë me rrëmbin.

E rregji i Egjiptianëve nënvet të Ebrenjëvet - njerës me énbër Sephora e jetrës që i thoshiën Fuà - i tha: Kur ndihëni lehonët ebrenje, kur ato janë lindiën, në isht dialë, vrinie; në isht vajzë nënd't'e lëni të rronjë.

Po nanit ju trëmbën t'in'Zoti e ngë bën si i urdhuroi të bëjnë rregji, e lanë djenët të rrojën. I thërriti rregji i Egjiptit nanit e i tha atireve: Përçë bët këtë e djenët i lat të rrojën? E ato i përgjegjën. Ebrenjet ngë janë si grat egjiptiane. Ato janë të forta; ato lindiën në para se t'ar-

rrojën nanit.

E in'Zot i bëri të nira atireve nanë e populli u shumësua e u nfortsua shumë.

Prokjin. Ms.128. Ju bekuan në énbër e t'in'Zoti.

Shunë herë në luftuan që nga djelnëria jine.

nga Libri i Jobit I,1-12.

Te hora e Avsidhitës rroj një njeri që i thoshiën Job. Ki burrë ishë ipakjërduashën, i dorëjt, i vërtët, i lutëshën e që ruhej nga çodë të bëna të liga. I len atij shtatë bij e tri bija. E shtazat e 'tij ishën: shtatë një dele, tri një kaniq, peskjint par kjesh, peskjint ghaidhurë e shërbëtorë tepër shumë. E shumë vepra të mëdha bëj ai në dheun. Te gjithë Lindia ishë njeriu në bujar.

E bijët e 'tij çodë ditë, njeri pas

t'jetrit, nbaj darkë ne t'jerë vëllë-
zër e thërrisiën edhe tri motrat sa
të hajën e të pijën ne ata.

Si sosëj rendi Jobi i bëj të vijën
sa t'i pastroj e në nëngjes, si gdihej,
ngrëhej e bëj flijë t'in'Zoti për ata
nbas numërit të 'tire e një viçë për
nëkatën për shpirtrat e 'tire .

Thëshëj në vërtetë Jobi: mos bijët
t'inë te mendiet e 'tire menduan gja-
gjë të kekjë kundra t'in'Zoti?

Një ditë që ëngjëjitë e Perëndis jër-
dhën të parakjiteshën përpara t'in'Zo-
ti, Satana ishë në mes të 'tire.

In'Zot i tha: nga je viën? E tue u për-
gjegjur dialli i tha t'in'Zoti: kan
vatur alarta e aposhta për në dhet.

E in'Zot i tha: e vëre orë nbi shërbë-
torin t'in Jobin, njeri i pakjertuashën,
i dërrëjt, i vërtët, i lutëshën që ruhet
nga çëdo të bëna të liga?

U përgjekjë dialli e i tha t'in'Zoti:
Isht dhurat që Jobi ndër t'en'Zonë?

Ngë stise Ti një garth rreth atij,
gjithë shërbisevet që ka brënda te
shpia e edhe gjithëve çëdo ka jashta?

E bekeve veptrat e duarëvet t'tija e
shunësove nbi dhet shtazat e 'tij?

Po nglat dorën t'ënde e ngiti gjithë
atë që i përket e do t'shohiën në ngë
ka të t'mallkonjë haptas.

E kloft , i tha in'Zot. Gjithë çëdë
ka t'i jap te duart, po atë mos e
ngit. E dolli dialli nga prania e
t'in'Zoti.

*si sosiën profetsit këndonet "katëf-
thinthito":*

Si livan le t'ngjipet përpara Teje
lutia jine ; të ngrëjturit e duarë-
vet t'ine flijë e nbrënëshme.

O Zot, u të thërrita Tij, gjegjënë;
vër re zërit e luties s'ine si u
të thërrës Tij.

Si livan...

E H Ë N I A E M A D H E _ _ _ _

Vëj, o Zot, një ruajtje gojës
s'ine e një derë rreth buzë
vet t'ine.

Si livan....

Mos lësh zënbrën t'ine të
lëshonet të kekjave; të kër-
konjë arsye për të mbrojtur
nëkatën t'ine.

Si livan ...

lëvdë past ... nanë ...

Si livan ...

Vangjeji si shkruan Mateu XXIV, 3-36.

Tek ai kjörë si Iisui ish'e rrij ujur
te mali i ullinjëvet, u kjasën atij
dsënësit e mbë nj'anë i thanë: Thuana
kur ka t'streksiën këto shërbise e ç-
li isht shengu i të ardhurit t'at e të
sosurit e jetës.

E u pergjekj Iisui e i tha: vërreni
nos njeri të ju gënjënjë: shunë vetë
ka t'vijën në énbrin t'in e do t'ju
thonë: U jan Krishti e ka t'gënjënjën

E H Ë N I A E M A D H E _ _ _ _

shunë vetë.

Ka të gjegjëni edhe të flasiën nbi lu-
fta e zëre luftash: ruhiq nos shkjetë-
sonij. Gjithë këto duhet të streksiën,
po ngë isht edhe të sosurit.

Do t'ngërëhet komb nbi komb e rregjë-
rë nbi rregjëri e do t'jenë urë e
nortie e ternete vende vende; gjithë
këto do t'jenë të zënit fill e vuaj-
tiëvet. Ahierna do t'ju japiën te
duart e arnikjëvet sa t'ju mudojnë
e do t'ju vrasien e gjithë gjindet
do t'ju kenë në mbëri për énbrin t'in.

E ahierna shunë vetë do t'narriën
skëndall e njeri jatin do të ngalesen
e urrënen. E ka t'ngërëhen disa pro-
fetra të rrenë e do t'gönjënjën shu-
në gjinde e për të shuësuarit e pa-
ligjëris dashuria e shunë vetëve do
të ftohet. E kush do t'ket durin nje-
ra në nbarin, ai do t'e shpëtonjë.

E ka t'ligjëronet ki vangjeji rre-
gjëris te gjithë jeta, për deshtë të
gjithë gjindëvet; e ahierna ka t'vinjë
të sosurit.

Ku pra të shihëni sihjenin e shkretirës që kle thënë nga Profeti Daniel të vëne ndë vend të shejt(a) që sgleth t'i vënjë mend) ahierna ata që ndodhen në Judhé, le t'jikiën nbi malet; e ai që ndodhet nbi shpin, nos të sdripet të narrënjë gjë nga shpia e 'tij. E kush ndodhet përjashta, nos të priret të narrënjë të veshurën e 'tij. Të njerat ju gra ne barrë e ju që jipëni sisë tek ato ditë. Po parkalesni të nos streksënjë të jikurit t'aj te dinëri a tek e shtunia. Se ahierna ka t'jet një helm i nath, si ngë ka klënë kurr që te të zënë e jetës njera n'nanë, edhé ngë ka t'jet. E në nos shkurtonenato ditë; ngë isht njeri nishi që mëndë t'e shpëtonjë, po paj të të Sgledhurëvet ka të shkurtonen ato ditë. Atëherë në ndonjëri ju thëft: shi' Krishti ë këtu ë këtié, nos e kini besë. Se ka t'dajën Krishtëra të rrenë e ka të japiën shengjë të nëdhenjë e fanasnë, akjë sa të gönjenen, në nëndë, edhé të Sgledhurit.

Shi' se U ju e kan thënë më para.

Andai në ju thëfshin: shihënie, isht në shkretirë, nos dilëni; shihënie, isht brënda te shpia, nos e kini besë.

Se, ashtu si shkretini del nga lehet dielli e duket njera ku ai perëndon, kështu ka t'jet të arrënët e të Birit e njeriut.

Teku do ndodhet kurn i vdekur, atié ka t'nbëjidhen shkjiponiat.

E shpejt pas helmit e atireve ditë dielli ka t'ërret e hënza ngë ka të japënjë dritën e 'saj e ijëzit ka të bien nga kjiellia e fukjit e kjiellia- vet ka të tunden. E ahierna ka të duket shengu i të Birit e njeriut në kjiell e ahierna gjithë gjindet e jetës kanë të vajtojën e ka të shohiën të Birin e njeriut që vien nbi ret e kjielliës ne zotëri e lëvdë të madhe.

E ka të dërgonjë ëndjëjitë e 'tij në trunbetën ne zë të nath e ka të nbëjë-

dhiën të Sgledhurit e 'tij nga katrë erët nga një majë e nj'atrë të kjielliavet. E nësoni nga fiku parabullën; po kur dega e 'tij të bënet e njomë, e t'i bien fletët, njihëni se vera ë afër. Kështu edhe ju, kur të shihëni gjithë ato shërbise, t'e dini se isht afër nbi diert.

Me të vërtetë ju e thon: ngë ka të shkonjë këjë jini njera që gjithë këto shërbise do t'streksiën. Kjielli e dheu ka t'shkojnë, po fialët t'ine ngë do t'shkojnë kurr.

*më para se "Nin e dhinamis" Zoti
prift, ndërsa diakëni këndon litani,
thot këto parkalesi:*

O Perëndi i nath e i lëvduashëm që nga prishëria neve na shkove në papri-shëri me vdekjien gjellëdhënëse të Krishtit t'önt, Ti lirona ndjenjat t'ona të gjitha nga epshtet (passionët)

që japiën mortë tue i vënë sipër atireve arsyen.

Le t'ruhet siu nga qëdë vërrejtie e kekjië; u mbillëshin veshët fialëvet të kota; gluha u pastroft nga të folatë pahjëshme; dëlirna buzët që të lëvdojnë Tij; bëj sa duart t'ona u nbahëshin nga të bëna të liga, po bëshin vetëm atë që Tij të pëlqën tue na ruajtur gjithë pjesat e kurnit e nondien ne Dhuratën t'ënde.

O i Zoti i shejt, shum'i mirë, të parkalesiën Tij që je i pasur te lipisit, kij nëshirë për ne të nëkatruanë e bën-na të zotë të presiën mirë Birin t'önt të vetnin ler e Perëndin t'ënë, rregjin e lëvdës.

Shi' se i dëliri Kurni i 'tij e gjellëdhënësi gjak nanë te këjë herë janë kjellurë - na pa par - sa të jenë vënë te Triesa Mistike nga lus-

na ushtrish kjellore. Ëna t'i narriën
piesë pa gjikin,sa me ata të jët ndri-
tur siu i mendies t'Ënë e na të bëneni
bij të dritës,bij të ditës.

N i n e d h ã n a n i s

Nani fukjët e kjielliavët ne ne për-
nist falen. E shi' se isht e viën Rre-
gji i lëvdës. Shi' flija mistike e
përsosurë,se vien kjellurë.

Me besë e dishirin kjaseni,sa të keni
piesë te gjella e pasosne.Aliluja.

*Si Diakëri këndon litanët më para se
"Ati i jinë" Zoti prift thot këtë
parkalesi:*

O Perëndi i Misterëvet të pathëshnë
e të paparshnë tek i Çili janë fshehu-
rë gjithëhë vistaret e diturës e të njo-
hies,çë na ke sbëluar shërbësën të kë-
saj liturjle,për të madhen dashanirësi
t'Ënde na vure neve të nëkatruanë të

Të fajiën dhuretë e flijë për nëkatët
t'ona e për të paditurat e popul-
lit.

Ti,o Rrekjë i padukëshën çë bën gjë-
ra të nëdha e të paarrënëshne,të lëv-
duashne,të jashtzakonshne e të pa në-
nëruashne,prir siun nbi ne shërbëtorë
t'atë të pavëjëfshnë çë rrin përpa-
ra kësaj therorie e shejte si përpa-
ra thronit t'Ënt të hjynushën hjeru-
vik nbi të çilin prëhet i Biri i jët
i vetëni ler e Perëndia jinë pr'anë
të misterëvet të dreruashnë të para-
vunë.

E tue na liruar neve e popullin
t'Ënt të besnë nga çëdë ndohtësi,
të gjithë neve shejtërona shpirtrat
e kurnet ne një bekin të pandsierr-
shën,sa ne vetëdijë të dëlirë,ne një
fakjie çë ngë ka përçë të ngukjet,
ne zënërrë e ndritëne;tue narrë piesë
te këta shejtërine t'atë të hjynushnë
e tue narrë gjellë nga ata,të bashko-
neni ne Krishtin t'Ënt Vet,të vërte-
tin Perëndi jini çë thot:"kush ha

nishët t'in e pi gjakun t'in kjëndron tek U e U tek ai". Kështu tue nbetur Fiala jote ,o Zot, bënda nesh e tue i banuar ,na bënomi faltore të gjithëshejtit e të proskjinisurshnit Shpirt, të lajturë nga çëdë dinakëri të dialit çë punon te të folit,te të bënat te mendimet t'anë e na të keni të mirat të taksura bashkë ne gjithë Shejtrat çë noti Tij pëlkjëshnë

E v l o j i s o ...

Dua t'bekonj t'ën'Zonë në çëdo kohë. Kloft lëvdini i Tij përherë te goja jine. Ngjepsni Bukën e kjielliç e kjelkjin e gjellës e do t'shiehëni sa i ënbël isht in'Zot . aliluja.

P l i r o t h i t o

U nbushëshit goja jine ne lëvdinin t'ënt,o Zot,sa t'nderonjë lëvdin t'ënde pse na bëre të mirë të nirri-ën pjesë te të shejtitë,të pavdekshnitë e të dëlirë Misterë t'atë. Mfortsona te të shejtëruarit t'at sa gjithëditën të nejtojmë drejtësin t'ënde.

Parkalesia jashta Vimës

O i Zot i gjithëmëndën çë bëre gjithë kriesën ne dituri,çë ne të pathë-nëshin parakujdes t'ënt e ne të na dhe nirësi na prure te këto ditë të lutshne për të pastruar shpirtrat e kurnet t'anë,për të zotëruar epshet t'ona,për na dhënë neve shpresën e të ngjallurit . Ti çë te dizëtë ditat skalise te drasat të hjynushmet të shkruame shërbëtorit t'ënt Moiseut, çna edhé neve,o i Mirë,të luftojën luftën e nirë,të nbarojën dhronin e argjërrinit,të ruajën besën të tërë,të shkeliën krerat e të patëdukëshnëvet drangoj e të dajën nundësorë të nëkatës e t'arrëjën t'i përniseni të Shejtes Ngjallie.Se u bekua e u lëvdua i ndoruashni e i nadhëruashni ënbër jit,i Atit...

Kloft bekuar...

Ms. Dua t'bekonj t'ën'Zonë në çëdë kohë;kurdoherë lëvdia e 'tij te goja jine.

E H È N I A E M A D H E - - - - -

Tek in'Zot do t'lövdonet shpirti i jin; le të gjegjen të butitë e të bëjnë haré.

Madhëroni t'ën'Zonë ne mua;gjithëbashkë le t'lartësojën énbrin e 'tij.

Kërkova t'ën'Zonë e në gjegji e në liroi nga gjithë ngushtimet.

Kjasij tek Ai e do t'jini ndriturë; fitirët t'uaja ngë ka t'ngukjen me turp.

Ki i njeri thërriti t'ën'Zonë e Ai e gjegji dhe e liroi nga gjithë helmet e 'tij.

Ëngjëlli i t'in'Zoti ka t'kjëndronjë rreth atireve që i trëmben Perëndis e ka t'i lironjë.

Ngjepsni e shihëni sa i ënbël isht in'Zot; i lun njeriu që shpreson tek Ai.

Gjithë shejtrat e 'tij trëmbij t'in'Zoti, se ngë do t'i lipset gjë atireve që i trëmben Atij.

Të kjosnitë u vapëkësuan e ndiejtën

E H È N I A E M A D H E - - - - -

uri;^{po}atireve që kërkojën t'ën'Zonë që do e mirë ngë ka t'i lipset.

Ejani, o bij, gjegjëni mua; u dua t'ju nësonjë trëmbësirën e t'in'Zoti.

Kush ë njeriu të çilit i pëlkjën gjella e dishiron ditë të lume?

Ai le t'ruanjë gluhën e 'tij e buzët e 'tij mos të thenë të rrenen.

Le t'ruhet nga e liga e let'bënjë të mirën; kërkofit pakjien dhe e nbaftshit gjithënonë.

Sit e t'in'Zoti janë nbi të dërejtitë e veshët e 'tij nbi parkalesin e 'tire.

Fakjia e t'in'Zoti isht kundra atireve që bëjën të kekjie sa t'i prishënjë edhe kujtinin nga dheu.

Uluritën të dërejtitë e in'Zot i gjegji e nga gjithë ngushtimet e 'tire i liroi.

E H È N I A E M A D H E - - - - -

In'Zot rri afër atireve që kanë zëmbrën e ngrijturë e do t'shpëtonj të përunjëtitë në shpirt.

Të shumë janë helmet e të dërëjtëvet; nga të gjithë do t'i lironjë in'Zot.

Ja ruan in'Zot eshtrat; as një ka t'i çahet.

E kekjie isht nortia e të nëkatruanëvet; ata që i nbajën mburi njeriut i dërëjt bëjnë nëkatë.

Do t'i lironjë in'Zot shpirtat e shërbëtorëvet t'Tij e ata që kanë shpresë tek Ai ngë do t'nëkatrojnë.

+

ORTHROS i të MARTIES

Japiëm këtë përkthimin e parkalesivet që thot Zoti Përfundim ndërsa te kori s'gledhen gjashtë msalmet:

Të faleni nderies s'ate, o Zoti Perëndia jinë se na ngrëjte nga shtrati e vure te goja jonë fialën e lëvdimit e të proskjnisurit e të të thërriturit ënëbrin t'ënt të shejt.

E i truheni lipisivet t'ote që gjithë herë Ti ke pasur për gjellën t'ënë.

Nani dërgë ndihmën t'ënde këtimeve që ke përpara fakjies e lëvdës s'ate e që presiën ngah Ti të shuna lipisit t'ote e jipi atireve sa tue u përnisur ne trënbësë e ne dashuri të lëvdojnë të parrëfleshmen nisësi t'ënde.

Se Tij të nget qëdë lëvdë, nder e të përnisur Atit ...

2. Çë natën shpirti i jin rri sgjuar përpara Teja, o Perëndia jinë, përçë dritë janë urdhurinet t'atë nbi dhet.

Ëna sa na të nbarojën ne trënbësirën t'ënde drejtësin e shejtërinin, se na japiën lëvdë Tij çë vërteta je Perëndia jinë. Prir veshin t'ënt e gjegjëna e kujto neve çë të jeni këtu përpara e nga-një ne énbrin e 'tij. Kujto gjithë ata çë parkalesiën për ne e shpëtoi ne fukjin t'ënde. Bekë popullin t'ënt e shejtëroë trazhginin t'ënt. Jip pakje jetës s'ate, klishëvet t'ote, kji-verritarëvet t'anë e gjithë popullit t'it. Se ushejtërua e u lëvdua i lëvduashni e i nadhëruashni énbri i jit i Atit ...

3. Çë natën rri sgjuar përpara Teje shpirti i jin , se dritë janë urdhurinet t'atë. Mësonë, o i Madh'in'Zot drejtësin t'ënde, urdhurinet t'atë, të drejtat t'ote. Ndris si e mendievet t'ona
62.

nos na të kjëllononi te nëkata nga gjuni i morties. Përzë nga zënbrat t'ona çëdë errësirë, falna neve dielin e drejtësis e ruana te sidçili i Shpirtit Shejt gjellën t'ënë.

Ndrekjë hapet t'anë te dhroni i pakjies. Ëna të shohiën aginin e ditën ne gözën sa të Të faliën lutiet t'ona e nëngjesit. Se jotia ë pushtetia ...

4. O Zoti Perëndi, i shejt e i pandëlguashën, çë the të shkëlqëj drita te të errëtisë, Ti çë na dhe prëhien te gjuni i natës e na ngrën sa të t'lëvdojën e t'i luteni Mirësis s'ate, prit mirë neve çë vijën e të përniseni e, për sa na nëndë Të haristisiën.

E falna gjithë atë çë na duhet shpëtnit t'ënë.

Dëftona vërteta bij të dritës e trazhgintarë të të miravet të pasosne.

Kujtou, o i Madh'in'Zot, në burin të lipisivet t'ote, për gjithë popullin t'ënt, për ata çë janë këtu ne ne e bashkë ne ne Të parkalesiën e për

ORTHROS i të MARTIES --

gjithë vëllëzëritë t'anë shprishurë
te gjithë jeta, për ata që ndodhen nbi
dejtërat e te çudë vend të të zotëru-
amit t'atë e parkalesiën dashanirësin
t'ënde e gjithëve fal të madhen lipisi.

Sa, të shpëtuarë te kurni e te shpirti,
të kjëndrojën të tillë e ne kudsën të
lëvdojnë të famasëshnin e të shejtëru-
amin ënbër t'ënt t'Jatit ...

5. O Thesari i së niravet, krua që bu-
ron përherë, Ati Shejt, thavnëbërës, i
gjithëmëndën e i pushtëtshën, na gji-
thë të faleni përnist e të luteni tue
lipur lipisit t'ote e nëshirët t'atë
për ndihmë e përkrahie ujtësës t'ënë.

Kujtoui për ne që të parkalesiën; prit
nirë lutiet nëngjesore të gjithë neve
si livan përpara Teje e ngak na nos
dëbë njeri, po të gjithë na kuturis ne
përdëjësat t'ote. Kuitoui për ata që
ngë flën sa të nsaliën për të lëvduar
Tij e Birin t'ënt të vetninler Perën-
din t'ënë e Shpirtin Shejt.

Klofshe për ata përkrahës e ndihmës.

ORTHROS i të MARTIES --

priti nirë lutiet te therorëja jote
e nondçne e kjellishte.

Se Ti je Perëndia jinë e na të fal-
ën lëvdë Tij Atit

6. Te faleni nderies s'ate, o Zoti Pe-
rëndi i shëndeties s'ënë; që bën gji-
thkjish për të nirën e gjellës t'ënë
sa na të kenë siun kurdoherë tek Ti
Shpëtuesi e Mirëbëresi i shpitravet
t'anë. Përçë Ti për sa u nglat nata
na bëre të prësheshën e nanë na ngrëj-
te nga shtrati e na prure të proskji-
nisiën ënbrin t'ënt.

Prandai të parkalesiën, o i Madh'inë
Zotëna neve hirin e fukjin sa të je-
ni bër të nirë të Të lëvdojnë e të
Të parkalesiën pa pushin ne trënbë-
si e dre, tue punuar kështu për
shëndetën t'ënë vetë ne ndihmën e
Krishtit t'ënt.

Kujtoui, o i Madh'in'Zot edhe për ata
që prizen tek Ti natën tue thirrur
Tij. Gjegji e kiji lipisi e drënë
përposh këmbëvet e 'tire çudo arnik
të padukëshën e kundrështor.

Se Ti je rregji i pakjes e na .65.

O R T H O S i t ë M A R T I E S

7. O Perëndi Ati i t'in'Zoti Iisu Kri-shti, çë na ngrëjte nga shtrati e na mbëjodhe te hera e parkalesis ëna Hirin t'ënt si të sbilliën gojën t'ënë e prit nirë të haristisurit çë të bëjën ashtu si nëndë e nësona të drejtat t'ote; se na ngë din të parkalesiën si duhet në ngë na udhëhëkjë Ti me Shpirtin t'ënt Shejt. Prandai na të lutemi: në na keni nëkatruar njer në sot ne të fola, ne të bëna, ne tru, tue dashur e pa dashur, falna, ndëjëna, kija na lipisi. Përsë në Ti vëshgon pali-gjet t'ona, o i Madh'in'Zot, kush nëndë t'e duronjë? Se tek Ti, o i Madhi in'Zot, ë shëlbesa.

Ti je i vetëni Shejt, ndihmës, i forti vëshgues të gjellës t'ënë e lëvdini i jinë ë gjithëmonë për Tij.

Kloft pushteti i rregjërës s'ate bekuar e lëvduar i Atit ...

8. O Zot Perëndia jinë çë largove ngak na përtinin e gjunit e na thërrite bashkë ne një thirrie të shejte sa çë

O R T H O S i t ë M A R T I E S

brënda natës të T'ngrëjën duart e të nadhërojën gjikinet e drejtësis s'ate, prit nirë lutiet, lipiet, nderinet, të përmisurit t'anë e falna, o i Madh'in'Zot, një besë pa turp, një shpre-së të sigurtë, një dashuri pa pësh-trin. Bekona të dalurit e të hijtu-rit t'anë, të bënat, veprat, fialët, di-shirinet t'anë e ëna të mendojën çë në të zënit fill e ditës të T'lëv-dojën, të Të innojën, të T'bekojën ni-sin e të pathënëdhmes ënbëlsi s'ate.

Se u lëvdua gjithishejti ënbër ji-ti e u bekua rregjëria jote e Atit...

9. O i Madh'in'Zot, i mirëth ne njrë-zit, bën se të shkëlqenjë te zënërat t'ona drita e thiellë për të njohur Hjynin t'ënde; e na sbill sit e nen-dies s'anë për të ndëlguar e nejtuar ligjirinin e vangjejit shejt, e na jip trënbësirën e urdhurinevet t'atë të

O R T H R O S _i_ _të_ M A R T I E S

lunë;akjë sa tue shkëlur dishiret e kurnit,na nënd't'ruajën dëtirët e shpirtit,tue nenduar e tue vepëruar gjithë atë që Tij të pëlqjën.

Pse Ti je , o Zoti Krisht Perëndi, të shejtëruanit e të ndriturit i shpirttravet e i kurnevet t'anë, e na të japiën lëvdën Tij Atit ...

10. O Zot Perëndia jinë që me pendimin i jep njerëzëvet ndëjësën e neve si shembërë të njohuri mëkatën e të skomollisuri ,na 'ftove që bëri Davidhi sa të kishë ndëjësën,Ti,o i Madh'inë Zot,paçe lipisi për ne që ram te mëkatë të mëdha e të shuma për sa e madhe isht lipisia jote e për sa të shuma janë përdëjesat t'ote shliej paligjet t'ona. Se na kemi mëkatruar Tij që njeh të errëshmat e të fshehurat e zëmbres s'njeriut,Tij që i vetëm ke zotërin të ndëjësh mëkatët.

68.

O R T H R O S _i_ _të_ M A R T I E S _.

E të vënit tek na një zëmërë të pas-trë e tue na mbajtur fort me shpirt së larti udhëtar e tue na dëftuar neve harën e shpëtimit t'ënt,mos na largë nga fakjëja jote,po si i mirë e njeridashës bën-na të mirë të T'faliëm flijë drejtësie e dhureti mbi therorret t'ote të shejte njera tek e sprasmia frimë.

Me dhuratën,me përdëjësat edashami-rësën të të vetëmitler Birit t'ënt me të Çilin je i bekuar me gjithëshejtin e i mirë e gjallsuar Shpirt t'ënt nanë ...

11. O Perëndi,Perëndia jinë,që gjithë fukjit të mendçme eshpirtullore i zotëron me vullimin t'ënt,na Të lutemi, të parkalesiëm:prit mirë këndimet t'anë,si të gjithë krientullavet t'atë,me të çilët kërkojëm,si mëndë,të t'japiëm lëvdë e na shpërblë me të

69.

O R T H R O S _i_ _të_ M A R T I E S _ _ _

kjosmët dhuretì të mirësis s'ate, pse përpara Tij ujet çëdò glu në kjiell, mbi dhe e përposh dheut e çëdò fri-më e kriesë të jep lëvdì pa pushim.

Se Ti vetëm je Perëndi i vërtet e s' shumë lipislar . Përçë Tij të këndo-jën gjithë fukjit e kjielliavet e na të japiëm lëvdì Tij Atit ...

12. Të këndojëm, të lëvdvojëm, të falemi nderies s'ate, o Perëndi, i atëravet t'anë se na fale të errëtitë e natës e prapë dritën e ditës, po i lutemi mirësis s'ate të na jesh afër te mëkatët t'ona e të pretsh mirë parkalesin t'ë-në me të madhen dhëmbëshirë t'ënde , përçë na rriedhiëm tek Ti që je një Pe-rëndi lipislar e gjithëmëndëm.

Le t'shkëlkjenjë te zëmbat t'ona di-elli i vërtet i drejtësis s'ate. Ndri-tna mendien e ndiënjat t'ona të gjitha na i ndrekjë sa na tue jetsur, si në di-

O R T H R O S _i_ _të_ M A R T I E S _ _ _ _

të e shkëlkjieme, te rruga e urdhurime-vet t'atë, t'arrëjëm te gjella e pasos-me, përçë tek Ti isht burimi i gjellës e ëna t'jemi bër të mirë të gëzojëm Dritën e përherëshme.

Se Ti je Perëndia e na të japiëm lëvdì Tij Atit...

*për "Shi' se Dhëndërrin vien" v. f. 18
pas këtij sglidhen këto:*

Τὸν Νυμφίον...

Le t'duam mirë, o vëllezër Dhëndërrin e përgatitiëm llëmpët t'ona tue i bër të bëjën dritë me virtutët e besën e dërëjtë sa si virgjërat e urta të t'in'Zoti gati të hijëm me Atë te das-mat. Dhëndërrin, si Perëndi, na jep gjithë neve një kurorë të paprishëshme.

O R T H R O S _i_ t_ë M A R T I E S _

Βουλευτήριον ...

Priftra e shkruanjësë për zill mbëjodhën këshillin e paligjësish kundra Teje, o Shpëtues e shtijtën tmerisht Judhën në tradhëti. E ai pa turp jerdhi e foli kundra Teje të paligjëvet tue thënë: çë më jipni e u ju e jap te duart? Nga dënimi i 'tij ruaj, o Zot, shpirtrat t'anë.

'O 'Ιούδας ...

Judha lakmon 'rrgjëndin, prandai vete kundra Mësuesit. Oh, i kekji!

Këshillonet, mejton tradhëtën. Bie nga drita e hin te të errëtitë. Ai tregton mbi Atë çë ngë ka çmim e për çmim të tradhëtisë i poshtëri gjen mortien tue u vierrë. Nga fat i ktillë ruajna, o Krisht Perëndi tue dhënë ndëjësën e mëkatëvet atireve çë me mall ndëriën Pessimet të dëlirë t'atë.

O R T H R O S _i_ t_ë M A R T I E S _

Vangjeji Mt. XXII, 15-46

XXIII, 1-39

Tek ai kjërë Farisënjtë mbajtën këshill kundra Iisuit, si ki't'e mirriën më gluhë e dërgojën atij dsënësit e 'tire me Erodhianët tue thënë: Mësonjës, dim se je i vërtet, se mëson udhën e Perëndis tek e vërtetia, se ngë ja ke mosnjeriu, se ngë vërren te fakjëja njerëzit.

Andai Ti na thuaj: si të duket? nget t'i jipet çensit Çesarit a jo?

E Iisui, se njohu të ligën e 'tire, i tha: përçë më shtini, ju ipokritë?

Pa dëftomni haromën e çendit. E ata i prun një dënar. E Ai i thot atireve: kuji isht këjë fitirë e këjë e shkruame? Ata i thonë: e Çesarit.

Ahierna Ai i thot: jipëni andai Çesarit atë çë isht të Çesarit e jipëni Perëndis atë çë isht të Perëndis.

E ata të gjegjurit kështu, u famasën e e lanë. e. vanë.

Tek ajo ditë u kjasën tek Ai Sadhu-kjenjtë çë thonë se ngë ka të ngja 73.

O R T H R O S i t ë M A R T I E S

llur e i piejtën tue thënë: Mieshtër, Moiseu tha: "në ndo-njeri vdes pa pasur bijë, i vëllau i 'tij ka t'martonjë grua an e 'tij e ka të ngjallënjë farën vëllaut e 'tij! Teq na ndodheshën shtatë vëllezër e i pari u martua e pra vdiqjë, e posa ngë kishë fëmijë, la gruan të vëllaut e 'tij. Gjitëashtu e i dijeti e i treti njera të shtatët.

E sprasmia e gjithëve vdiqjë edhe gruaja; Te të ngjallurit pra kuj ka t'jet, nga të shtatët, grua? Përçë gjithë e patën për grua. U përgjekj Iisui e i tha atireve: gënjenij pa njohur as të Shkruamet as fukjën e Perëndis. Përçë, si të ngjallen, ata ngë marriën grua as martonen, po rrojën si ëngjëj të Perëndis në kjiell.

Mbi të ngjallurit së vdekurish pra ngë sglodhët atë çë na la thënë in'Zot çë thot: U jam Perëndia i Abramit e Perëndia i Isakut e Perëndia i Jakobit? Ngë isht Perëndia Perëndi të vdekurish, po të gjallësh.

O R T H R O S i t ë M A R T I E S

E gjindia, si gjegjën, u famasën mbi mësimin e 'Tij.

Farisenjtë kur gjegjën se Ai kishë kjetur Sadhukjenjtë, patën një mbëledhie. E një nga ata, një ligjëtar, i piejti, sa t'e planesëj, tue thënë:

Mieshtër, çili urdhurim isht më i math te Ligja? E Iisui i tha atij: "të duash mirë t'ën'Zonë, Perëndin t'ënt, me gjithë zëmëren t'ënde e me gjithë shpirtin t'ënt e me gjithë mendien t'ënde. Ki isht i pari urdhurim. I dijeti i glet këtij: të duash mirë gjitonin t'ënt si vetëhën. Te këta urdhurime vëzet gjithë Ligja e tërë e Profetrat."

Kur pra klenë mbëjedhurë bashkë farisenjtë, Iisui i piejti atire tue thënë: "çë ju duket mbi Krishtin? kuji isht bir?" I thonë: "i Davidhit". E i thot atireve kështu: "si Davidhi ndë shpirt e thërret Zot tue thënë:

ORTHROS i të MARTIES

"Zoti i tha t'im'Zoti:uju tek e drejta jime njera që të vë armikjët t'atë nën këmbëvet t'ote"?

Prandaj në Davidhi e thërret TË ZOT, si isht biri i 'tiji?"

E mosnjeri mënd't'i përgjegjej një fialë:as kle njeri që kudsoi më që tek ajo ditë t'i piej.

Ahierna Iisui zu t'i flisëj gjindevet e dsënësëvet e 'Tij tue thënë: "mbi kathedhrën e Moiseut janë ujurë shkruesit e farisenjtë. Andaj gjithë atë që të ju thenë,t'e ruani e t'e bëni:mos bëni ashtu si janë të bëmat e 'tire,se ata thonë e ngë bëjnë.

Përçë lidhiën barrë të rënda e që ngë mënd't'kjelliën e i vën mbi krahët e njerëzëvet:pran ngë duan t'i tundiën me glishtin e 'tire.

Të gjitha ato të bëma ata i bëjnë sa të jenë vërrejturë nga njerëzit.

Sgjerorjën filakteriet e 'tire e

ORTHROS i të MARTIES

nglajën theket e së veshurës.

Duan të parët vende te të ngrënë e të parët throne te sinagogët e të falat te tregjet e të jenë thërritur mieshtër,mieshtër. Ju mos t'doni të jini thërritur mieshtërë,pse po Një isht Mësonjësi i jij,Krishti. Ju të gjithë jini vëllezër. E mos thrini njeri mbi dheun at i jiji , pse po një isht At i jij , Ai që ë te kjiellia. Mos t'jini thërriturë "mësonjësi",pse po Një isht Mësonjësi i jij , Krishti. E më i madhi ngak ju ka t'jet shërbëtuat i jiji.

E kush do t'bënet i lart , ka të ujet ; e kush do të ujet , ka të jet ngrëjtur lart. Vaje për ju shkruasë e farisenjë ipokritë,se mbëllini rregjërin e kjielliavet përpara njerëzëvet. Posa ju ngë i hini,ngë lëni të hijën ata që do t'hijën.

Mjerët ju shkruasë e farisenjë ipo-

ORTHROS i të MARTIES

kritë, se gjëllini shpit e të vejavet, përqë bëni skuna do t'parkalesni glat: prandai do t'kini mundim të math.

Vaje për ju e helme, shkruesë e farisenjë ipokritë, se veni tue rrahur për dejt e për dhe sa të kërkonin një të priret nga in'Zot, proselit e pra, si të vinjë, e bëni atë bir pisie më shumë se ju. Mjerët ju udhëheqësë të verbërë që thoni: kush të bënjë be mbi faltoren, ngë isht gjë: ai pra që të bënjë be mbi arin e faltores, bie në dëtitirë. Të lënë e të verbërë: çili isht më i math: ari a faltoria që shejtëron arin? Edhé ju e thoni, se ai që të bënjë be mbi theroren, ngë isht gjë: ai pra që të bënjë be mbi dhuretën, bie në dëtitirë. Të lënë trush e të verbërë: që isht më e madhe dhuretia a theroria që shejtëron dhuretën? Prandai ai që bën be mbi theroren bën be mbi atë e mbi gjithkujsh që janë atië sipër. E kush bën be mbi Faltoren, bën be mbi

78.

ORTHROS i të MARTIES

Kë jet atië. E kush bën be mbi kjielliën, bën be mbi thronin e Perëndis e mbi Kë i ujet sipër.

Mjerët ju, shkruesë e farisenjë të fshehtë që paguani të dhietëtën e menderes, e mbrajit, e susanit e lëni mbë nj'anë të rëndat e Ligjës: gjikimin, lipisin e besën. Këto do të bënen e ato nos të lëhen.

Mieshtërë të verbërë që shkulloni mushkojën e përtilni gamilin.

Të mjerët ju, shkruesë e farisenjë ipokritë që lani ajashta kjelkjin e tajurin e abrënda jini të plotë me kusurë e me dishire të likjë.

Farisë i verbër, pastrë më para mbëan't'abrënda kjelkjin e tajurin sa t'jenë të pastruane edhe ajashta.

Vaje për ju, shkruesë e farisenjë ipokritë: se i glini varrëve të sbarthurë që m'an't'ajashta duken të bukurë e brënda janë të plotë me eshtra të vdekurish e me gjithë sihjenë.

Kështu edhe ju: ajashta, gjindes i dukij të dërëjtë e abrënda jini të plotë me ipokrisë e me të kekja.

79.

O.R.T.H.R.O.S i të M.A.R.T.I.E.S

Të njerët ju që stisni varret e Profetravet e sbukuroni kujtimet e të drejtëvet e thoni: në kishëm klënë na te ditët e t'atravet t'anë,ngë kishëm marrë piosë me ata te gjaku i Profetravet. Kështu ju deshmoni ju vet,se jini të bijët e atireve që vran profetrat. E ju mbëluat masën e prindravet t'aj. Gjarpinjë,këlushë nepërkash, si mëndë të shpëtoni nga ligja e pisës?

Prandai shi' se U ju dërgonj Profetra të urtë e shkruesë:e te këta,tsa ka t'i vryni e ka t'i vëni ngrikj,e tsa ka t'i rrahi me shkupinjë te sinagogët t'uaja e ka t'i përzëni kjitet mbë kjitet,sa t'vinjë mbi ju gjithë gjaku i dërëjt derdhur mbi dheun,nga gjaku i Abelit të drejt njera te gjaku i Zaharës,të birit e Barahjës,çë vrat në mes të Faltores e të Therores.

Për të vërtetë ju thon se ka t'vijën gjithë këto shërbise mbi këtë jini.

Jerusalim,Jerusalim,çë vret Profetrat e kjëllon ne gurë ata që janë dërguarë tek ti,sa herë desha të mbëjidhia bijet

O.R.T.H.R.O.S i të M.A.R.T.I.E.S

t'atë,si pula mbëjëth zokjët e 'saj përposh krahëvet,e ju ngë deshët.

Shi' se shpia e juaj isht e ju lëhet e shkretë.

Andai ju thon:s'ka të në shihëni që nani e para njera të thoni: I bekuar Ai që vien n'ëmbër të t'in'Zoti!

Ms.50 v.f. 23.

pas sinaptis e vogël

kondakji Τὴν ὤραν ψυχῆ...

Mendë ne dre,o shpirti jin orën e sprasne e të prerit e fikut.Andai punë me zënërrë talandin që të kle dhënë tue u mbajtur i sgjuan e tue thirrur t'in'Zoti:nos na le të nbetëni jashta nusërores t'Krishtit .

Përçë flë,o shpirti jin i dobët, përçë ;përçë llojas pa arsye kujdese të kota;përçë tërbone për atë që shkon?Nani isht ora e sprasne e keni të ndaheni nga të këtushmet.

ORTHROS i të MARTIES

Njera çë ke kjërò ngreu tue uluritur:
nëkatrova kundra Teje, Shpëtuesi jin.

Mos në prit si fikun pa penë, po si
Krisht lipislar kij lipisi për mua çë
ne dre të ulurinj: Mos mbetshin jash-
ta nusërores s'Krishtit!

TEK E SHEJTA DHE E MADHE E MARTIE
PËRMENDIËM PARABULLËN E DHJETË VIRGJË-
RAVET ÇË na rrëfien Vangjeji i shejt

E Martia e Madhe na parakjit dhietë
virgjëreshat çë patën mundien përpara
të paprishëshmit Zot.

O Krisht Dhëndërr, nëmërona bashkë ne
të urtat virgjëreshë e bashkona gri-
gjes e sgledhurë t'ënde e kijna lipi-
si.

ODHA E VIII

Τῷ δόγματι, τῷ τυραννικῷ...

Posa ngë morën 'veshë urdhurin e Ti-
rafit, tri djentë klenë shtënë te fur-
ri e lëndojën Perëndin tue kënduar:

Bekoni, o vepra të t'in'Zoti, t'ënë
Zonë.

ORTHROS i të MARTIES

Ῥαθυμίαν ...

Shtien largu nesh përtinin e ne llën-
pë çë ndritiën veni të përpiëkiën ne
hinne të pavdekshin Dhëndërr Krishtin
tue kënduar: bekoni, vepra të t'in'Zoti,
t'ën'Zonë.

Ἰακωβῶσθω...

Kloft njaft vajët e shokëris te rro-
gjetë e shpirtit t'ënë; nos paçin të
veni t'e blen kur ka t'presien Dhën-
dërrin e të këndojsin: Vepra të t'in'Zo-
ti, bekoni t'ën'Zonë

Τὸ τάλαντον...

Gjithë ju çë kini pasur talandin nga
Perëndia - edhe një akjë i vlërshën
hir - shumësonie në ndihmën e Krish-
tit çë ju e dha, tue kënduar: Bekoni, o
Vepra të t'in'Zoti, t'ën'Zonë.

ODHA E IX

'H τὸν ἀχώρητον Θεὸν...

Na lëvdojën Tij, o Virgjërë, gjith'e
shejte që në gji përmbajte të papër-
nbajturin Perëndi e linde gëzinin
për jetën.

Ταῖς Μαθηταῖς . . .

I thëshie dsënësëvet t'atë, o i Mirë,
rrini sgjuarë pse ju ngë dini në që
herë in'Zot ka të vinjë për të ju
shpaguar çënjërin sa t'i prierënjë
nga-njeriu jush atë që i nget.

'Ev τῆ δευτέρῃ σου . . .

Te të jardhurit t'atë të dijtë të
dreruashëm, o i Madh'in'Zot, vurënë
tek e drejta ne delet pa vërrejtur
shunizën/e nëkatëvet t'ine.

Τὸν νυμφῶνά σου βλέπω

Nusëroren t'ënde shoh, Shpëtues
të stolisurë; po të veshurën u
s'kan sa të hinjë tek ajo.

Ndritësonë pra stolin e shpir-
tit, Dritëdhënës, e shpëtonë.

për msalmet vërrej f.31.

'Ev ταῖς λαμπρότησι...

Si ka t'hinjë u i pavëjëfshin te lam-
barit e Shejtravet t'atë?

Në u gudsonj të hinjë te dasnat e ve-
shura në ngalës pse ngë isht dasnie.

E lidhur nga ëngjëjitë ka t'jon
shtur jashta. Pastrë, o Zot, nga çodë
ngjolle shpirtin t'in e shpëtonë si
njeridashës.

ORTHROS i të MARTIES

Ὁ τῆ ψυχῆς ῥαθυμία . . .

Për përtinin e shpirtit t'in u kjëllova gjuni e ngö kan një llënpë që dhizet në virtutët e i glava virgjëreshavet të lëna tue vatur atëi e këtëi kur ki t'punoja. Mëshirët e lipisis t'ënde mos mbill nua,po ngrënë tue e në shkundur nga ki gjun i errët e bashkonë ne virgjëreshat të urta te dasnët t'ote ku ndihet zëri i dëlir t'atireve që të bëjnë haidhë tue kënduar pa pushin. O Zot,paçe lëvdë!

Dhoksa ...kje nin... Τοῦ κρύφαντος

O shpirti jin,posa gjegje dëninin e atij që fshehu talandin,mos fshih finalën e t'in'Zoti;lajmërë fanasnët e 'tij sa të shunësosh Dhuratën e të hish te hareja e Zotit t'ënt.

86.

ORTHROS i të MARTIES

për vazhdimin e Akoluthis

vërrej f. 36 Si dhoksa prepi...

njera në f. 39.

A P O S T I H A

ΔΕΥΤΕ ΠΙΣΤΟΙ . . .

Nanë, o të besnë, le t'punojnë në zell për t'ën'Zonë. Ai dhuron shërbëtorëvet pasurin. Atë herë nga-njeri nosh nbi atë që pati le të shunësojëi talandin e Dhuratës. Kush le të stolisënjë diturin në vepra të mira,kush le të përsosënjë një shërbën i shkëlqjen,kush i besën le t'vunjë në pjesë të Fialës të paditurin e jetri le të dhuronjë kjosnët e 'tij të vapkjëvet. Kështu na bëjnë të shunësonet atë që ka t'keni e si ikononë të besnë të Dhuratës do t'jeni të mirë për harën e t'in'Zoti. Të asaj bënëna të mirë Ti,o Krisht Perëndi,si njeridashës.

87.

O R T H R O S i t ë M A R T I E S

"Όταν έλθης έν δόξη . . .

Kur të vishë në lëvdë ne fukjit ëngjëllore e do t'ujesh në thron të gjikinit, o Iisu', mos në largë, o Dëlmier i mirë. Ti njeh në vërtetë udhët e dërëjta e të shtrëmbërat që kjelli-ën në prishie. Mos në bashkë nua, i that për nëkatën, ne dhit, po nënëro-në ne delet e të Dërëjtës e shpëtonë si njeridashës.

Ὁ νυμφίος ὁ κάλλει ὠραῖος

O Dhëndërr në i bukuri i gjithë një-rëzëvet që na thërret neve te darka shpirtullore e dasmavet t'ote, dëshë-në nga e veshura e trashë e nëkatëvet t'ine tue në vënë në piesë të pesinevet t'atë e tue në stolisur ne të veshurën e bukuris t'ënde tue në bër një darkëtar gaznor të rregjërës t'ënde, o Lipisiar.

O R T H R O S i t ë M A R T I E S

Dhoksa...kje nin... 'Ιδού σοι τὸ
τάλαντον...
Shi', o shpirti jin, in'Zot të truan
talandin; me dre prit mirë dhuretën;
jipia hua atij që t'e dha: tue e ndar
ne të vapëkjat bën nik t'ën'Zonë: sa
pra t'i rrish tek e dërëjta kur Ai të
vinjë në lëvdë e të gjegjesh të lumin
zë: "hir, o shërbëtuar, te hareja e t'it
zoti. Të kësaj hareje bëj të mirë
nua të aratisurin, o i Madh' in'Zot,
paj të të madhes lipisi s'ate.

Agathon to eksomolojisthe ...

T r i s a j i

Kondakji v.f. 81

A p o l i s i s v.f.42

PROJASME NA E TË MARTIES S'MADHE

*te Kji r i e e k j e k r a k s a k ë n d i m e t j a n ë
p a m e t a a t a t ë M ë n g j e s o r e s v. f. 85.*

P r o f e t s i t

Ms.131. Ngreu, o i Madh'in'Zot, nga
pushini jit:Ti e arka e shejtërinit
t'ënt.

Kujtò, o i Madh'in'Zot, Davi-
dhin e gjithë butësìn e 'tij.

nga të DALIT II,5-10.

U sdrip e bija e Faraonit të lahej
te luni e shërbëtoret e 'saj jitsiën
rrëzë rrëzë lunit.

E si pa kanistrën në kënetë, dërgoi
shërbëtoren e 'saj sa t'e nirrëj.

E si ajo e sbilli pa dialin që klaj.

E u mallengjie e bija e Faraonit e
deshi t'e shpëtoj e tha: ki ka t'jet
nga fënija e Ebrenjëvet.

E ahierma e notra i tha të bijës
s'Faraonit:do sa të thërres një grua
nga dhengjizat ebrenje t'i japënjë si-
së dialit? E e bija e Faraonit i tha:

P R O J A S M E N A e të MARTIES

éts. Vate vajza e thërriti nënën e di-
alit. I tha kësaj e bija e Faraonit:
mirrë kujdesin e këtij fëniji e jipi
sisë për mua. U du t't'paguanj.

E gruaja mori dialin e zu t'i jipëj
sisë. Si pra diali u bë i nath e kjel-
li tek e bija e Faraonit. E u bë si
bir i 'saji e ajo i dha énbër MOISE
"se u e shpëtova nga ujërat.

Ms.132. Shi' sa bukur isht e të
pëlkjeshën për vëllezërit të rrin
gjithëbashkë.

Si vaj érósh nbi kriet që
kullon nbi njekërrën, njekërrën e
Aaronit.

nga libri i Jobit I,13-22.

E streksi se një ditë që bijët e bi-
jat e Jobit ish'e hajën e pijën te

PROJAS MENA e të MARIES

shpia e vëllaut t'nath, një lajntar jerdhi te Jobi e i tha: kjet ish'e punojën e ghaidhurët ish'e kulotiën e ju sulën kusarët e i kjellën e djentë që i ruajën i vran ne thikë.

Shpëtova u vetën e jerdha të t'e thëshia. Si ai edhe flisëj, jerdhi një atrë lajntar te Jobi e i tha: ra zi-arr nga kjiellia e dogji dele e del-nerë e u vetëni që shpëtova jerdha të t'e rrëfëja. E si ki edhe ish'e flisëj, jerdhi një atrë e tha: kalorësit bën tri rradhë, rrethuan kanijët e i kjellën bashkë si jikën e vran ne thikë ruanjësit. U i vetën i shpëtuan jerdha të t'e thëshia. Si ai edhe flisëj, një atrë lajntar vien te Jobi e i thot: si bijët t'atë e bijat t'ote ish'e hajën gjithë bashkë, jerdhi një erë nga shkretira e ngrëjti katrë an-gonët e shpis e shpia ra nbi bijët

PROJAS MENA e të MARTIES

t'atë e vdikjën. Shpëtova u vetën sa t't'e thëshia. Si gjegji këto Jobi, shkjoorri të veshurën, zu të shkuloj kripët e rar me fakje përniat pros-kjinisi t'ën'Zonë e tha: Nga gjiri i nënës t'ine dolla nilikurë e ash-tu do t'këthehen. In'Zot n'i ka dhë-në, in'Zot n'i ndsori. Si i pëlkuje t'in'Zoti, ashtu kle. Kloft bekuar émbri i 'Tij për gjithëmonë. Te gjishtë këto që i streksën ngë nëkatroi Jobi përpara t'in'Zoti as ne buzët e 'tija e ngë shajti t'ën'Zonë.

kërkò Katëlfthinhtë f.47

V a n g j e j i XXIV,36-51;
XXV, 1-46;
XXVI,1-3.

I tha in'Zot dsënösövet e 'Tij:Mhi atö ditö e nbi atö orö nosnjeri di gjë,as edhé öngjüjit e kjielliayet, veç se vetën po Tata i jin. . Si ditöt e Noeut,köshtu edhe ka tjet të arrönit e të Birit e njeriut.

Pörçë si te ditöt në para se pörmbitia hajën e pijën,nirriön grua e nar-toneshën njera te dita çö hiri Noeu te arka e ngö ndölgojën njera çö jerdhi pörnbytia e i rnarti të gjithë, köshtu do të jet edhé të jardhurit e të Birit e njeriut. Ahierna di do ndodhen pörjashta:njeri do t'jet marrë e jetri lönö;di çö bluajën te nulliri:njera do t'jet marrë e jatra lönö.

Andai rë rrini sgjuarö se ngö dini

nö çö herö vien i zoti i jij.

Tö dini edhé kötö: se nö dij i zoti i shpis nö çö herö të natös ki't'vij kusari,ai dej të rrij sgjuar e ngö löj të shpojön shpin e 'tij.

Prandai të jini edhé gati:se tek ajo herö çö ngö duket,vien i Biri i njeriut. Kush isht andai ai shörbötör i besër e i urt çö nga i zoti ö vönö sipër shörbötörövet të 'tij sa t'i japönjë atireve gjörin te hera e të ngrönit? I lum ai shörbötör çö i zoti kur vien e gjen të bönjë köshtu. Me të vörtetö ju thon se ai do t'e vönjë nbi gjithë të nbarën e 'tij. Po nö ai shörbötör i kekjë thot te zönbra e 'tij:"jin zot nënon" e zö fill të rahönjë shokët e 'tij e të hanjë e të pinjë ne të dejmit,i zoti i atij shörbötöri do t'vinjë te dita çö ai ngö e pret e te hera çö ai ngö di e atö do t'e ndanjë e t'e vönjë nbë nj'anë bashkö ne ipokritöt. Aié ka t'jet të klar e të grijtur dhënbësh.

PROJAS MENA e të MARTIES

Rregjëria e kjielliavet i glet atireve virgjëresha të çilat nuarën hërnaret e 'tire e i dualtin përpara Dhëndërrit. E tek ato, pesë ishën të lëna e pesë të urta. Të lënat nuarën hërnaret e 'tire e ngë nuartin vaj bashkë ne 'to. Po të urtat nuartin vaj bashkë ne 'to, te rrogjet e 'tire bashkë ne hërnaret. E posa Dhëndërrin u noj, ato të gjitha zun të kjëlloneshin gjumi e flëjën. E te gjinsa e natës u ndie një thirrme: shi' isht e vien Dhëndërrin, dilnëji përpara.

Ahierna u ngrëjtin të gjithë ato virgjëresha e dërtuan hërnaret e 'tire.

Të lënat i thanë të urtavet: na jipëni neve tsa nga vajët t'aj, se hërnaret t'anë jan'e na shuhen. E të urtat ju përgjegjën tue thënë: jo, nos ngë na arërnëve edhe juve: në mirë etsëni tek ata çë e shesien e e blini për ju.

Po si ish'e vejën t'e blijën, jerdhi Dhëndërrin: e ato çë ishën gati, hijtën bashkë ne atë te dasnat e u nbill dema.

PROJAS MENA e të MARTIES

Ndë vonë vijën edhe t'jerat virgjëresha tue thënë: zot, zot, sbillëna.

E ai u përgjekjë e i tha: vërteta ju thon: ngë ju njoh.

Andai rrini sgjuarë, se ngë dini ditën as herën kur vien i Biri i njeriut.

Ashtu edhe një njeri ish'e vej larëgu e thërriti shërbëtorët e 'tij e i la te duart e 'tire të nbarën e 'tij çëdo kishë. E njërit i dha pesë talande e t'jetrit di e një njëi t'jetri: nga-njeriu nbë nëndien e 'tij e shpejt u nis e vate.

Ai çë kishë pasur pesë talande nori e vate e i shërbeu e bë edhe pesë talande. ashtu edhe ai çë kishë di: shtoi edhe ai t'jerë di.

Por ai çë pati po një, nori e vate e grënoi te dheu e fshehu 'rrgjëndin e të zotit t'tij.

Mbi disa mot vien i zoti i atireve shërbëtorë e zë e bën logarit ne ata.

E ju kjas ai çë mori pesë talanda e e i vu përpara t'jerë pesë talande

PROJASMENA E TË MARTIES - - - - -

tue thënë: i zoti, në ke dhënë pesë talanda, shi' se u i shtova sipër nbi ata t'jerë pesë talande. Atij i tha i zoti i 'tij: shunë nirë, shërbëtuar i nirë e i besën pse nbi të paka ti kleve i besën, u dua t'tbënjë i zot nbi të shuma: hir në haré të t'it'zoti.

Ju kjas edhe ai që pati di talande e i tha: i zoti, në ke dhënë di talande, shi' se fitova nbi ata t'jerë di talande. Atij i tha i zoti: shunë nirë, shërbëtuar i nirë e i besën, pse nbi të paka ti kleve i besën, u dua t't'bënjë i zot nbi të shuma: hir në haré të t'it zoti.

Pra edhe u kjas ai që kishë pasur një taland e i tha: i zoti, dija se ti je një njeri i ashpër, që kuar tekun ngë mbolle, e se mbëjëth edhe ngaha ngë s shprishe e i trëmbur vajta e fsheha talandin t'ënt nën dheut: shi' këtu' ke t'ëndin. E atij ju përgjeki i zoti i 'tij e i tha: shërbëtuar i lik e i prituashën. Ti dije se u kuar ku u ngë mbolla e se u mbëjëth ngaha u ngë shprisha? I duhej andai se ti të

PRJAS MENA e të MARTIES

lëje 'rrgjëndin t'in triesarëvet e, të jardhurit, u kisha narrë t'inin në penë.

Ndsirënëji nanë këtij talandin e jipënia atij që ka dhietë talande; pse atij që ka, ka t'i jipet e ka t'i buronjë e atij që ngë ka ka t'i ndsiret edhe atë që ka.

E shërbëtorin të pavëjëfshën shtënie te të në t'arrëtitë të jashtën: atë ka t'jet të klar e të grijtur dhëmbësh.

Kur të vinjë i Biri i njeriut në lëvdë të 'tij, edhe gjithë ëngjëjitë bashkë në atë, ahierna ka t'ujet nbi thronin e lëvdës 's' tij . E kanë të mbëjidhen përpara Atij gjithë gjindet, edhe Ai ka të ndanjë ata njerin nga jetri, si delneri ndan delet nga katsikjët. Delezit ka t'i vënjë te ana e dërejtë e 'Tij e katsikjët tek e shtrëmbëra. Ahierna rregji ka të thet

atireve tek e dërejta:ejani ju,të be-
kuanit e Tatës t'in, trazhgoni rregjër-
rin të gatiturë për ju që kur kle sti-
surë jeta. Se pata urë e në dhat të
haja,se pata etë e në dhat të pija;
kleva i huaj e në nbëjodhët brënda;
në likurë e në veshët; u sëmura e je-
rdhët e në pat;kleva ndë fulakji e në
erdhët tek U. Ahierna ka t'i përgje-
gjen Atij të dërejtisë tue thënë:Zot,
kur të pan të urn e të dhan të haje?
a të that etiet e të dhan të pije?

E kurtë pan të huaj e të këllitënë
brënda? a në likurë e të pështruan?

E kur të pan të sëmur,a ndë fulakji
e jerdhën tek Ti? E rregji ka t'i përg-
jegjet e ka t'i thet atireve:ne të
vërtetë ju e thon:sa herë ja bët nje-
rit nga këta vëllezër t'inë të vegjit,
n'e bët mua. Ahierna Ai ka t'i thet
atireve te ana e shtrënbërë:shkoni
ngak U ju që klet mallkuarë e jetsni

te zjarri i pasosën i përgatitur për
diallin e për ëngjëjitë e 'tij.

Se pata urë e ngë në dhat të haja;
pata etë e ngë në dhat të pija.

Kleva i huaj e ngë në nbëjodhët;
dçeshur e ngë në veshët;sëmur e në
fulakji e ngë jerdhët e në pat.

Ahierna ka t'i përgjegjen edhe ata
tue i thënë: Zot,kur të pan të urn
a të that etiet a të huaj a nëlikurë
a të sëmur a në fulakji e ngë u ste-
nën sa të t'shërbëjën?

Ahierna ka t'i përgjegjet atire tue
thënë: ne të vërtetë ju thon: sa herë
ngë ja bët njëi nga këta në të vegjit,
edhe mua ngë n'e bët.

E këta ka të venë në mundin të pa-
sosën e të dërejtisë në gjellë të pa-
sosne. E streksi se kur Iisui so-
si gjithë këta fialine,i tha dsënësë-
vet e 'tij:të dini se pas di ditë do
t'jenë Pashkët e i Biri i njeriut ka
t'jet përdhënë sa t'jet vënë në krikjë.

pas 6 msalmet -v. f. 5 e për lutiet
e pas alilujariit këndonet: f. 61-

Idhù o Nimfios érhjete... f. 18.

K A Θ I Σ M A T A

Πόρνη προσήλθέ σοι

Kurva të kjaset tue derdhur lotë e vaj érësh. Me urdhurinin t'ënt ë liruarë nga kjelbësira e nëkatëvet, kur dsënësi i kuji frina isht Hiri i jit, jo i mirënjohës, atë e përëbuz e gjishet me bajta tue 'shitur Tij për laknën e 'rrgjëndit.

Ἰουδαῖος ὁ δόλιος

Judha gënjeshtar i narrë nga laknia e 'rrgjëndit mendon me gënjin të të tradhëtonjë Tij Vistari i gjellës.

Rrieth si i dejn te të paligjët e i
102.

thot: çü doni të në jipëni e u ju e dorëzonj sa t'e vëni ngrikjë?

Ἡ πόρνη ἐν κλαυθμῷ

Kurva tue klar lurin, o Lipisiar, e ter kënbët t'ote të pastra ne flokët e kriës s'aj e tue rëkuar thellë thoshëj: nos në hith Teje, nos në përëbuz, o Perëndia jin, po nanë çü pendonen pritënë mirë si i vetëni Mik i nje-rözëvet.

V a n g j e j i Iani XII, 15-50

Tek ai kjërë bëj deshmë gjindia çü ishën bashkë ne Iisuin kur thërriti Lazarin nga varri e e ngjallu së vdekurish.

E prandai gjindia i vejën përpara, përçë kishën gjegjur se kishë bër atë famasnë. Andai farisenjtë thëshiën ndër 'ta: e shihëni se ngë bëjën gjë? Shi' gjithë jeta i vete prapa.

E ishën tsa grekëra ndër ata çü u kishën hipur sa të proskjinisiën tek e

krentia. Këta u kjasën Filipit që ishë nga Betsaidha të Galilés e i luteshën tue thënë: Zot, na dua shohiën Iisuin.

Filipi vien e ja thot Andreut e pane-ta Andreu e Filipi ja thonë Iisuit.

E Iisui ju përgjekjë atire tue thë-në: jerdhi hera të lëvdonet i Biri i njeriut. Me të vërtetë ne të vërtetë ju thon se në kokjia e drithit kur bie te dheu ngë vdekshit, ajo këndron e vetne; po në vdekshit ajo bën shu-në penë. Aë që do mirë jetën e 'tij, e sbier; por aë që nban gjellën e 'tij në mbëri në këtë dhe, e ruan për gjel-lë të pasosne. Në ndo-një në shërben mua, le t'më vinjë prapa; e ku jan U atië le t'jet edhe shërbëtori i jin; e në ndo)një në shërbefshit mua, atë Ati ka t'e nderonjë. Nani shpirti i jin isht i tërbuar: e që do t'thon?

Tate, shpëtonë nga këjo orë? Po pran-dai arrura u te këjò orë.

Tate, lëvdò énbrin t'ënt. Jerdhi ahier-na një zë nga kjiellia: edhe e lëvdova e paneta ka t'e lëvdonj.

Gjindia pra që rrij atië e që gje-gji, thoshëj: se kle një gjëmë. T'je-rë thëshiën: se një ëngjëll i foli atij. U përgjekjë Iisui e i tha: jo për mua u ndie ki zë, po për ju.

Nani isht gjikini i kësaj jetë. Nani urdhuronjësi i kësaj jetë ka t'jet shtur jashta. U kur t'jen ngëjtur lart nga dheu që gjithë ka t'i helkjë tek U. E këtë e thëshëj të dëftoj ne që vdekje kishë të vdisëj: U përgjekjë atij gjindia: na gjegjën nga Ligja se Krishti këndron për gjithëmonë: e si thua Ti se i Biri i njeriut duhet të jet ngrëjtur lart? Kush ë ki Bir i njeriut ?

I tha andai atireve Iisui: edhe pak këjërò drita isht ne ju. Jitsëni nje-ra që kini dritën sa nos t'ju zënjë të errëtitë e aë që jets te të errë-titë ngë di ku vete. Njera që kini dritën të kini besë te drita sa t'ji-ni bij të dritës. Kështu foli Iisui e posa vate , këndroi si i fshehur për ata.

O R T H R O S _i_ _të_ MËRKURIES _ _ _

Po nbi gjithë se Ai bëri fanasnë ka-
kjë të nōdha përpara atireve , ngē pa-
tōn besō.tek Ai. Sa të nbaronej fiala
e Isaia Profet çō tha: o Zot,kush e
pati besō atō çē gjegji ngak na? E fu-
kjia e t'in'Zoti kuj i ka klōnō sbōlu-
ar? Prandai ngē mēd't'kishōn besō,se
Isaia Profeti tha pameta:"Verboi sit
e 'tire,e bëri të thatō zōnbrēn e 'ti-
re , sa nos të shohiōn ne sit,e nos
tō ndōlgojōn me zōnērōn e të ndōrrojōn
mendie e U t'i shōndoshē."

Kōto tha Isaia kur p a lōvdin e 'yij
e foli për atō. Me gjithē kōtōedhē
shunē nga të Parēt patōn besō tek Ai,
po për dre të Faris enjēvet ngē e sko-
nollisōn,nos t'ishōn pērzhōnē nga Si-
nagoga. Pērçē deshōn nō ninō lōvdin
e njerzēvet se lōvdin e Perōndis.

- E Iisui thirri f ort e tha:Ai çē ka
besō tek U,ngē ka besō tek U po tek Ai
çē nō dōrgoi:Ai çē sheh Mua,sheh Atē
çē nō dōrgoi.

U , dritō nō jetō , jerdha sa nga-njē
çē ka besō tek U;nos të kjēndronjē nē

O R T H R O S _i_ _të_ MËRKURIES _ _

errōtitō. E nē ndo-njē gjegjēshit
fialēt t'ine e ngē pa çit besō,U ngē
e gjikonj;pse U ngē jerdha(te jeta)
sa të gjikoja jetōn,po sa t'shpōtoja
jetōn. Kush nē pōrbuz Mua e ngē pret
fialēt t'ine ka Kush e gjikon;fiala
vetē e lajnōruarē ngak U do t'e gjī-
konjē tek e sprasnia ditē; pse U ngē
fola ngak U,po Ati vet çē nō ka dōr-
guar,nē ka urdhuruar çō ka t'thon e
ka t'nōsonjē. E U e di se urdhurini
i 'Tij isht gjellō e pasosne.
Prandai fialēt çē ju thon ashtu ju
i thon si n'i tha Ati.i jin.

pas msalmit 50 (v. f. 23)

kēdonet Triodhii

TRIODHION

Τῆς πίστεως ἐν πέτρῳ . . .

Tue në nfortsuar te shkënbi i besës
sgjerove gojën t'ine kundra arnikjē-
vet t'inë. U gëzua shpirti jin te
të kënduarit: s'ka i shejt sa Perēn-
dia i jinë, s'ka i dërëjt veç Teje,
o i Madh'in'Zot.

Ἐν κενοῖς τὸ συνέδριον . . .

Më kot Sinedhrii i t'paligjēvet
nbëjidhet ne mendinin i kekjë të dē-
nonjë Tij Shpētues, o Krisht. Na Tij
po thoni: Ti je Perënd ia jinë, s'ka
i shejt veç Teje, o i Madh'i n'Zot.

Τὸ δεινὸν Βουλευτήριον . . .

I tnerreshëni këshill i të paligjēvet
ne shpirt sulmues kundra Perēndis,
mendon të vrasënjë si i nërzitshën të
Dërëjtin, Krishtin, të Çilit na këndo-
jën: s'ka njeri i shejt veç Teje, o
i Madh'in'Zot.

kondakji Ὑπὲρ τὴν πόρνην . . .

Kam mëkatruar më se kurva, o i Mirëth,
po lume lotësh ngë kam derdhur përpa-
ra Teje. Nanë në heshtie të shtihem
përmist tue puthur me dashurë të pa-
ngarët këmbë t'ote sa të më japësh
ndëjesën e mëkatēvet, o i Madh'in'Zot,
mua, o Shpētues, çë Të thërres, nga
bajtat e të bëmēvet t'ime liromë.

Ajo grua çë më para kishë klënë
gjithëbashkë u 'ftua e urtë. E ur-
rejyi të bëmat të turpëshme të mëka-
tës e ëndiet e mishit tue menduar tur-
pin të mathë e dënimin i pisës çë do
t'viajën kurvët e të ndohtitë. Të kë-
tireve u trëmbem të jem i pari, po i
lënë u kjëndroqj me të shkretitë za-
konë t'ime, kur kurva me dre rrodhi
njize tue thërritur Lironjësit: o mik

ORTHROS i të MËRKURIES

i njerëzëvet e Lipislar, nga bajtat e të bëmëvet t'ime, liromë.

TEK E SHEJTA DHE E MADHE E MËRKURIE PËRMENDIËM, si urdhuruan Atërat të shejtë, GRUAJA ÇË LIEJTI ME MIRON TË EN'ZONË, pse ki shërbës stëksi pakë më para se PESIMET TË SHPËTUESË.

GRUAJA DERTH MIRON mbi Kurmin e Krishtit më para se t'e bënë N_i kodhimi.

O Krisht Perëndia jinë që pate të lijturit shpirtullor, lirona nga epshet shumë llojesh që na sulen e kijna lipisi, se Ti vetëm je i Shejt e do mirë njeriun.

ORTHROS i të MËRKURIES

ODHA e VIII

Ἦμμα τυράννου . . .

Posa fiala e Tiranit pati më shumë fukji, furri kle djegur shtatë herë më shumë. Po djemtë ngë u dogjën se të rregjit pëbuzën urdhurimin e këndojnë: o ju gjithë veprat e t'in'Zoti këndonin e lartësonin t'en'Zonë për gjithëmonë. Δάκρυσι πλύνει; . . .

Me lotë lan këmbët e Kriuesit e nglakuamia me mëkatë e i tër me flokët e 'saj e kështu ka ndëjësën e mëkatëvet e thërrët: o ju gjithë veprat e t'in'Zoti, këndonin e lartësonin t'ënë Zonë.

Ἱερούργεῖται. . .

Për gruan e mirënjphësë mbaronet shpërblimi paj të mëshirit të shpëtues të Krishtit e të burimit e lotëvet të të çilat, posa lahet, s'ka më përçë të ngukjet, po thërrët: o ju gjithë veprat e t'in'Zoti, këndonin e lartësonin t'ënë Zonë.

'ΑΠΟΚΕΝΟΥΣΑ . . .

Si gruaja derdhi e dreruame të çmuamin Vaj mbi kriet t'atë, Perëndi e i Zot, me duart të ndyeme shtrëngoi këmbët të dëlira t'otë e uluriti: o ju gjithë vepra të t'in'Zoti, këndonit e lartësonit t'ën'Zonë për gjithëmonë.

ODHA e IX.

Ψυχὰς καθαράς . . .

Me zëmbra të pastra e me buzë të pandyeme le t'madhërojëm të papërliemen e shumë të pastrë Mëmën t'Manuilin tue i falur me anë të 'Saj lutie Atij që leu nga Ajo: ndëjëna mëkatët t'ona o Krisht Perëndi, e shpëtona!

'Αγνώμων . . .

Tue u dëftuar i pa-mirënjohës e smirzë i kekjë bën logarë mbi dhuretën që ishte e mirë për t'ën'Zonë e që atë e liron nga dëtitira e mëkatëve. Bën tregëtë i ziu Judhë mbi atë punë dashurie për t'ën'Zonë. Ndëjë shpirtrat t'anë,

112.

o Krisht Perëndi e shpëtona.

Λέγει πορευθείς . . .

Ai vete te të Parët të paligjë e i thot: Çë doni të më jipëni e u ju jap Krishtin që kërkoni? Për arin ai mohon mikjësin e Krishtit. Ndëjë shpirtrat t'anë, o Krisht Perëndi, e shpëtona.

Ὁ πρωτιῆς . . .

Oh, lakmë e pashuashme dhe e verbërë e 'rrgjëndit! Si mëndë të harroje se as jeta e tërë vëlën sa shpirti, si pate mësuar? E ti u dëshpërove e u vore! O Krisht Perëndi, ndëjë shpirtrat t'anë e shpëtona.

Ἐξαποστειλάριον Τὸν νυμφῶνα...

Nusëroren t'ënde shoh, Shpëtues, të stolisurë; po të veshurën u s'kam sa të hinjë tek ajo. Ndrëtësomë pra stolin e shpirtit, Dritëdhënës, e shpëtomë.

për Misalmet v. f. 31

O R T H R O S i t ë M È R K U R I E S -- 1/2

Σὲ τὸν τῆς Παρθένου 'Υιὸν . n/2 .

Tij të Birin e Virgjërës tue të njo-
hur si Perëndi thëshië tue parkalesur
me lotë se punë për të klar ajo kishë
bër. Sglidhëmë dëtirën si u sglith gër-
shetat ; duajëmë mirë se u të dua mbi-
gjithëse 'ki't'më urreje me të dërëjtë,
e do t't'ligjëronjë Tij si Mik i voi-
shtarëvet, o Mirëbërës, Mik i njeriut.

Τὸ πολυτίμητον . . . n/2

Të çmuamin vaj érësh kurva përziej-
ti me lotët e 'saja e derdhi mbi këm-
bët t'ote që ngë sosëj të puthëj.

Atë Ti njëiherie e shejtërove .

Ipna neve ndëjësën, Ti që vuajte për
ne e shpëtona.

"Ὅτε ἡ ἀμαρτωλὸς . . . n/2

Kur e mëkatruamia fali vajët, ahier-
na dsënësi u muar 'veshë me të paligjëjt.

Ajo gjith'e gëzuame derdhi të çmuamin
Vaj, a! rrodhi të shisëj Atë që ngë mën-
dë të çmonet, të Paçmuashmin. Ajò njo-
hu të Zotin, a! nga i Zoti u nda. Ajò

O R T H R O S i t ë M È R K U R I E S --

u lirua nga armiku, Judha u bë robë i
'tiji. I tmerrshëm pakujdesi i 'tij,
të mathë të prierit e 'saj. Këtë me-
tanie ëmë edhé mua, o Shpëtues që vuan
për ne e shpëtona.

Ὁ τῆς 'Ιούδα ἀθλιότητος . . . n/2

Oh, poshtërsi të Judhës ! A! sheh kur-
vën që puthë këmbët e t'in'Zoti e men-
don me gënjim puthien e tradhëtis.

Ajo sglithë gërshetat e a! lidhet me
mbëri. Në vend të Mirit kjeh kjelbësi-
rën e të ligës. Šmiri me të vërtetë
ngë di të sgledhënjë që isht më mirë.

Oh, poshtërsi të Judhës ! Nga ajo
ruana shpirtrat t'anë, o i Madh'in'Zot!

d h o k s a 'H ἀμαρτωλὸς . . . n/2

E mëkatruamia rrodhi të blij vajët
érësh të çmuam shumë sa të liej Mirë-
bëresin. E atij që e shisëj i thëshëj:

O R T H R O S i t ë M È R K U R I E S

ëmë Mirin sa të lienj'Atë që më shliej-
ti gjithë mëkatët.

k j e n i n ... 'Η βεβουσιμένη *κχσπβ*

Ajo që ishë humburë te mëkata gje-
ti Tij liman i shpëtimit e tue derdhur
mbi Tij vajët érësh me lotë,të thërri-
sëj Tij: shi' Aì që kjeh ndëshkimin e
atireve që mëkatrojën. Po Ti,o i Zot,
liromë nga përmbitia e mëkatëvet t'i-
me.

*për vazhdimin e Aholuthis
v. l. 36 Si dhoksa prepi...
njera në l. 39*

A p o s t i h a

Σήμερον ὁ Χριστός . . . *κχσπβ*

Sot Zoti Krisht vien te shpia e Fari-
seut e një grua e mëkatruame i kjaset
e i shtihet te këmbët e i thot:shiko-
116.

O R T H R O S i t ë M È R K U R I E S

më:jam e humburë te mëkata,jam e dë-
shpëruame për atë që kam bër,po ngë
jam e përbuzurë nga mirësia jote.
Ipëmë edhe mua , o i Madh'in'Zot,
ndëjësën e të ligavet e shpëtomë.

"Ἠπλωσεν ἡ πόρνη . . . *κχσπβ*

Kurva flokët e 'saj ndej përpara Te-
je,i Zoti,kur Judha ndej duart e 'tij
të paligjëvet. Ajò sa t'mirrëj ndëj-
sën,aì sa t'mirrëj 'rrgjëndin. Andai
Tij që kleve shitur e që neve na liro-
ve ulurijëm: o i Madh'in'Zot,paçe
lëvdi !

Προσῆλθε . . .

Një grua me kjelbësirën e mëkatëvet
dhe e ndohtë u kjas tek Ti e derdhi
lotë te këmbët t'ote tue paralajmë-
ruar pesimet t'atë. Si mëndë të Të
vërrenj, o i Zoti jim ? Po Ti jerdhe

O R T H R O S i t ë M E R K U R I E S - -

sa të shpëtoje kurvën. O Ti që ngrëj-
te Lazarin nga varri pas katrë ditë,
ngremë mua që jam e vdes nga honi e
pritëmë mirë mua të mjerën, o i Madhi
in! Zot e shpëtomë.

Agathon

E dëshpëruame për sjellën e bërë,
e njohurë për sjellien e 'sajgruaja
t'u kjas Tij tue prur Mirin e thoshëj:
o i ler nga Virgjëra, mos më largo mua
të ndohtë. Ti që je hareja e Ëngjëjvet,
mos pëbuz lotët t'ime, po pritëmë mirë
nanë që pendonem, Ti që kur mëkatroja
ngë më përbuze paj të madhes lipisis
s'ate.

d h o k s a ...

O Zot, gruaja që ka rar te shumë mëka-
të e ndien Hjynin t'ënde! Tue ndëlguar
se ka t'jet Miroforia jote të fal me
lotë Mirin e të varrëzuarit t'ënt.

118.

O R T H R O S i t ë M E R K U R I E S - -

Oh; mjera u , ajo thot: për mua ë
këjë natë pa dritë hënzie, tërbim të
errët ndohtësie, lakmim mëkatie.

Prit mirë burimet e lotëvet, Ti që
rrnar te miekullat ujërat e dejtjit.

Përuju rökimevet e zëmbres t'ime,
Ti që përuje kjiellin kur me të pa-
rrëfieshëm vjershë mosgjë u bëre.

Dua të puth ato këmbë të pafajshme,
ato këmbë të t'çilëvet te Parraisi
Eva gjegji tingullin e hapëvet.

E të mëkatëvet t'ime shumësin e të
këkjivet t'ime honet kush do të vë-
shgonjë, o Shpëtuesi i shpirttravet?

Oh, mos e përbuz, Ti që e pamaturshme
ke lipisin, shërbëtoren t'ënde.

A g a t h o n t o e k s o m o l o j i s t h e ;

T r i s a j i

K o n d a k j i v. f. 109

A p o l i s i s v. f. 42

+

119.

*te Kjirie ekjekraks këndimet
janë pameta ata të Mëngjesores
v.f.114*

P r o f e t s i t

Ms.135 Lartësoni Perëndin e kjielli-
avet

Lartësoni Perëndin e perëndi-
vet.

nga TË DALIT
II,11-23.

Tek ato ditë Moiseu , si u rrit-
u bë i mathë-vate gjeti të bijët e
Israelit,të vëllézërit e 'tij.

Njohu sa vuajën te punët e 'tire
e një ditë pa një egjiptian që i ji-
pëj shkupinjë njëi nga vëllézërit e
'tij,t'bijët e Israelit. Ahierna aë
vërrejti nga gjithë anët e si pa se
mosnjerë e shihëj,mori e vrau egjip-
tianin e e fshehu te rëra.

Të nesërmen dolli pameta e shi' di
ebrenjë që zësheshën ndër'ta. Aë i tha

sulmuesit:përgë kset shokun t'ënt?

E aë i tha:kush të vuri krie e gji-
këtar ndër nesh?Omse do t'më vratsh
si vrave dié egjiptianin? U trëmp
ahierna Moiseu e tha:të flasënjë ki
kështu vien më rar se u dsu shërbesi.

Edhé Faraoni e dsuri e dej të vrisëj
Moiseun,po aë jiku nga fakjësja e Fara-
onit e vate të rrij në Madiam e si ar-
ru atië u uj afër njëi putsi.

Prifti i Madiamit kishë shtatë bija
që kulotiën delet e t'jatit t'tire Jo-
thori. Këto jerdhën te putsi sa të mi-
rriën ujë e sa të mbëlojën lugjet sa
t'potisiën delet e t'jatit Jothori.

Po si arrun t'jerë delmerë,këta për-
zun vashazit. U ngre ahierna Moiseu
e i mbrojti tue i ndihur të mirriën
ujët e të potisiën delet e 'tire.

Kur ato u pruarën brënda,i jati i
tha: si kle që sot bët kështu njize?

U përgjegjën ato:një egjiptian na li-
roi nga duar e barinjëvet e na mori u-
jët e na potisi delet. E ku ndodhet
aë nani,i piejti të bijavet.Thërrinie

PROJASMENA e të MËRKURIES

të vinjë e hanjë bashkë me ne .

E Moiseu kjëndroi atië te shpia e atij burri e ai pra i dha për grua një nga të bijat, Sepforën. E këjò i lindi një bir e Moiseu i vu emër Jirsam tue thënë: se u jam shtektar në vend i huaj . E pati pra edhe një atrë bir e e thërriti Eliezer, tue thënë: "Se Perëndia i tatës t'im ka klënë n ndihma jime e më liroi nga duart e Faraonit.

O i Madh'in'Zot, lipisia jote isht për gjithëmonë. Mos përbuz veprat e duarvet t'ote.

Ka t't'lartësonj, o i Madhi in'Zot, me gjithë zëmërë .

nga libri i Jobit II, 1-10

Një ditë që ëngjëjit vanë e u parakjitën përpara t'in'Zoti, i vate edhe dialli në mes t'tire. E i tha in'Zot: ngaha vien ti ? E i thadialli t'in'Zoti: kam vatur atei e këtei tue kjarkuar

PROJASMENA e të MËRKURIES

gjithë dheun. E in'Zot i tha: vëre orë mbi Jobin, si mosnjeri mbi dhet i glet atij: njeri i pafajshëm, i lutshëm, i vërtet, i pakjërtuashëm, që ruhet nga ç'dò e ligë edhe isht i pafaj? Ti më shtijte t'i prishia gjithëkjishë më kot. Tue i përgjegjur dialli i tha t'in'Zoti: "likurë për likurë e gjithë ç'dò ka njeriu ë gati t'e japënjë në shkëmbim të gjellës s'tij. Po ndoj dorën t'ënde e ngiti eshtrat e mishët e'tij e shohiëm në ka t't'bekonjë në fakjie." E in'Zot i tha diallit: Shi' U jam e t'e jap te duart. Ruaji vetëm gjellën. E dolli dialli nga fackjëja e t'in'Zoti e kësiti Jobin me një varrë e ligë që te kriet njera te këmbët. Jobi mori një tsopë poçie e çarë sa t'kruhej e rrij ujur mbi një grumbull plësh jashta kjitetit.

Si shkoi shumë kjërò , e shokjia i tha: njera kur ka t'duronj tue thënë:

shi' u pres edhe pakë kjërò shpresën e shëndëtës? Shi' se ka s' duket kujtimi i jiti nga jeta si edhe të bijëvet e të bijavet, e gjirit t'im dhoje e mundime që pesova mëkot e ti rri ujur mbi kjelbësirën e krimbëvet e shkon natën jashta e u që vete atei e këtei tue shërbier nga një vend te nj'atrë, nga një shpi te nj'atrë tue pritur të perëndonjë dielli sa të prëhem nga mundimet e të lodhëtiti. Ata nanë më shtipiën. Po thuaji ti t'in'Zoti ndo fialë e vdikjë. E a! tue e vërrejtur i tha: përcë flet 'shtu si një nga grat pa tru. Në pritëm mirë të mirat nga duart e t'in'Zoti, përcë ngë ka t' durojëm të ligat? Me gjithë këtë që i streksën ngë mëkatroi Jobi as me buzët e 'tija e ngë shajti t'ën'Zonë.

kërkò Katefthinthito

në f. 47

Posa ndodhej Iisui në Betanë te shpia e Simonit, të sgjeburit, ju kjas një grua që kishë një rrogjë alabastrit e plotë me vaj ërësh të shtrëjt shumë e ja derdhi mbi kriet Iisuit që ishë vënë te triesa. Si pan kështu dsënësit e 'tij u mbërijtën, tue thënë: përcë këta të sbierrë? se këta vaj ërësh mënd't'shitej shumë fort e t'i jipej të vapëkjëvet. Por Isuthi si e gjegji, i tha atireve: përcë e varesni këtë grua? Ajo më ka bër Mua një veprë të mirë. Se të vapëkjiti i kini gjithëherë me ju, Mua pra ngë më kini gjithë herët. Se tue shtur ajo këta vaj ërësh mbi kurmin t'im, ajo e bë skur për të varrëzuar Mua. Vërtetazi U ju thon, se atie ku të ligjëronet te gjithë jeta ki vangjeje, atie ka t'flitet e të thuhet atë që bëri ajo për kujtim të 'saj. Ahierna njeri nga dimbëdhietit, që thritej Iskariot,

mori e vate te të Parët e priftravet
e i tha atireve: çë do t'më jipëni e
u ju e jap Atë te duart?

E ata kjëndruan t'i jipiën tridhietë
dënarë t'rrgjëndë. E çë ahierna ai vej
tue kërkuar viershin sa t'ja jipëj
te duart .

*për parkalesit të veçante të
Prozamenës vërrej në f.52 e t'jera.*

*pas 6 Mxajmet - v.f., e për
lutiet f.61 - e pas alilujariit*

këndonet:

"Οτε οι Ένδοξοι Μαθηται . . .

Kur Apostojitë të lëvduashmë te
të lajturit e darkës ndriteshën,
Judha i kekjë,i sëmur nga lakmia e
'rrgjëndit errësonej e jipëj te du-
art e gjikëtarëvet të paligjë Gji-
këtarin të dërëjt. Vërrej di dashu-
ronjësi i haromëvet për 'ta vate
sosi se u mbi. Mbaju largu nga i
ligu çë këtò kudsoi kundra Mieshtrit.
O i Madh'in'Zot,çë je i mirë me
gjithë,paçe lëvdì!

V a n g j e j i Lk.XXII,1-39.

Tek ai kjërò kjasej e krentia e të
patëngridhuravet çë i thonë PASHKË.
E kërkojën kriepriftrat e shkruesit
si t'e vrisiën se i trëmbeshën gjin-
des. Hiri pra Satana te Judha çë i
thoshiën Iskariot e çë ishë një nga

dimbëdhietit e ki vate e i foli kriep-
priftravet e shkruesëvet r të parë-
vet e ushtarëvet si ki't'ja jipëj te
duart. U gëzuan ata e i dhanë fialë t'i
jipiën 'rrgjënd. Ai pranoi e kërkoj
viershin si t'ja jipëj te duart pa tra-
zim. E jerdhi dita e patëngrihuravet
kur i duhej te thereshën Pashkët; e dër-
goi Pietrin e Janin tue thënë:jetsëni
e na shtroni Pashkët sate ham. Ata i
thanë atij: tekun do Ti se të shtrojëm?

Ai i tha atire:shi' kur ju të hini te
kjiteti,ka t'ju vinjë përpara një nje-
rë që kjeh një shtëmbë me ujë:ju jetsë-
ni bashkë te shpia ku hin ai. E t'i
thoni të zotit e shpis: Micshtri tij
të thot:ku isht vendi ku dua U të ha
Pashkët me dsënësit t'imë? E ai ka
t'ju dëftonjë një dhomë e madhe,mirë
të shtruanë : atie shtromi triesë.

Ata vanë e gjetën ashtu si atire i ki-
shë thënë:e shtruan Pashkët.

E kur jerdhi hera, u vu te triesa Ai
e bashkë me Atë dimbëdhiët Apostojit.

E i tha atire:me dishirim U dishirova
të haja këto Pashkë me ju më para se
të shkonjë pesimet.

O R T H R O S i t e I N T I E S _ _ _ _ _

Se u ju thom juve se ngë ka t'ha më
nga ato njera që të mbaronen te rregjë-
ria e Perëndis. E të marrit një kjelkjë,
u fal nderies e tha: mirrëni këtë e nda-
nie ndër ju: pse U ju thom juve se ngë
ka t'pi më nga lëngu i dhris njera që
të vinjë rregjëria e Perëndis.

E mori tsa bukë e , të falurit nderies,
e çajti e ja dha atireve tue thënë:
"k i i s h t Kurmi i jim i dhënë për
ju:bëni këtë për të kujtuar Mua".

Kështu edhé,posa që sosën të ngrëni,
mori kjelkjin tue thënë:" Ki kjelkjë
isht Dhiata e re te gjaku i jim që der-
dhet për ju". E mbi gjithë shi' dora
e atij që ka me përdhënë Mua, isht këtu
me Mua mbi triesën. E i Biri i njeriut
nanë isht e vete si isht urdhuruar;po
mjeri ai njerë për anë të çilit ai ka
t'jet përdhënë. E ata zun të piejën
njeri t'jatrën ndër'ta,kush mënd'tishë
nga ata ai që ki't'bëj këtë shërbës.

E zun pra të zësheshën ndër'ta,se çili

prej atire dukej se ishë më i mathë.

Ai i tha atire:rregjërat e gjindëvet zotërojën ato e ata që kanë pushtetie mbi ato thërriten mirëbërësë. Po ju jo kështu:se në i madhi ndër ju ka të jet si më i vogëli e ai që bën krie si ai që shërbën. Se kush ë më i mathë: a ai që rri ujur te triesa a ai që shërbën. Ngë isht ai që rri ujur? po U jam në mes juve si ai që shërben. Ju edhe jini ata që kini mbetur ne Mua te gudsinet t'imë:edhé U dua të ruanjë një rregjërë ashtu si Tata jin e ruajti për Mua, sa të hani e të pini mbë triesën t'ime te rregjëria e jime e sa të ujj mbi throne tue gjikuar dimbëdhietë farët e Israelit. Tha pra in'Zot: Simon,Simon, shi' Satana vete tue kërkuar sa t'ju shoshënjë juve si shoshet drithët:por U parkalesa për Tij,sa nos të lipset besa jote; e ti kur të priresh një herë,mfortsò vëllezërit t'atë.

Ai i tha atij: Zot,me Tij u jam i mirë të vete e në fulakji e në vdekjie .

Ai i tha:Pietër,U të thom se sot ngë ka të këndonjë gjeli më para se ti të më mohish tri herë tue thënë se ngë Më njeh. E i thaatireve:kur ju dërgova pa kuletë,pa trastë e pa këputsë, mos ju lips gjë juve? Ata thanë:mosgjë. Andai i tha atireve: Po nanë kush ka kuletë,le t'e marrënjë;ashtu edhe trastën,e kush ngë ka , le të shesënjë të veshurën e sipërme e të blenjë një shpatë. Se U ju thom juve,se edhe këjò e shkruame duhet të mbaronet mbi Mua:" e kle nënëruar Ai ne të paligjëjt".

Vërteta gjithë ato që në ngasiën kanë të sosur tek U. Ata thanë:"Zot,shi'këtu di shpatë". Ai i thot atire:arrën.

E dolli e zu dhronin,si kishë zakonë, për malin e ullinjëvet e i vanë prapa dsönësit e 'Tij.

për Misalmin 50 v. f. 23

T r i o d h i i

ODHA e I

Τηθελση τμάρτα...

Dejti i kujjë isht ndajtur nga purteka e prerë;honi që ushkjen valët isht tertur e bënet dhrom për ata që janë pa armë e varrë për të armatosuritë.

E na një odhë si i përkét t'in'Zoti këndojëm:ne lëvdì të madhe u pështrua Krishti Perëndia jinë.

Ἡ παντατρία ...

Dieja e pakufishme,burimi çëdò e mirie,kroi i gjellës te shejta Mëmë e Povirgjërë stisi shpin e 'saj tue e veshur ne një faltore nishi.

U pështrua me lëvdì të madhe Krishti Perëndia jinë.

Μυσταγωγούσα ...

Dieja e vërtetë e Perëndis tue kallur te misteret mikjët e 'saj,përgatit një triesë që ushkjen shpirtrat e nbëlon kupën e pavdekjies të besmëvet. Kjaseni me lutësi e thërresiën: me lëvdì e madhe u lëvdërua Krishti Perëndia jinë.

Ἀκουτισθῶμεν ...

O gjithë të besnë,gjegjemi Diejën të pastisurshme,të njëklënëshme të Perëndis që me ligjërata e lartë po na thot: ngjepsni e si shihëni sa jam i ënbël,këndoni: ne lëvdì e madhe u pështrua Krishti,Perëndia jinë.

ODHA e III

Κύριος ὄν πάντων . . .

I Zot tue klënë i gjithësis, Perëndi
Krijonjë, Ti, çö s'vuan, bashkove Tij, tue
u vapëksuar, naturën t'önë e ju fale si
Pashkö atireve për të çilët veje të
vdisie tue thënë: hani Kurmin t'in e do
t'mfortsonij te besa.

Ῥύσιον παντός . . .

Kjelkjin t'önt i harës plot çö liron
gjithë njerëzin, o i Mirë, bëre të pi-
jën dsënësitë t'atë tue bër flijë ve-
tëhën t'önde tue thënë: pini gjakun
t'in e do t'mfortsonij te besa.

Ἄφρων . . .

Burri pa tru, tradhëtori çö ë në mes
juve, i thua Ti dsënësëvet t'atë, o i
pafajshëm, ngö ka të njohënjë këtë ni-

ster; ki burrë pa ndëlgin ngö ka të
kuptonjë; po ju kjëndroni tek U e do
t'mfortsonij te besa.

Καθ. Ὁ Λίμνας . . .

Ai çö bëri likjenet, dejtërat e kro-
njet më dha në të mirën shembërë për-
unjësie: tue u rrethuar me një nsallë
lajti këmbët e dsënësvet. Tue u përu-
jur se ka një zënërrë tepër e njonë,
na ngrëjti nga honet e të kekjies i
Vetëni Mik i njeriut .

Ταπεινούμενος . . .

Tue u përunjur për zëmërrënjonë lajti
këmbët e dsënësvet t'atë e i ndrekje
të dhroni i hjynushën. Ngö dej Pietri
t'ishë lar, po nori veshë urdhurin
t'önt e të lutej t'na jipie neve te
madhen lipisi.

Συνεσθύων . . .

Tue ngrënë bashkö, o i Madh'in'Zot,
me dsënësit t'atë nistikjisht i dëf-
tove flijinin t'önde të shejt.

(vazhdon) 135.

O R T H R O S i t ë I N T I E S _ _ _

Neve që nderiën pesimet t'atë të s
shejtë me atë na lirove nga prishëria.

ODHA e IV Προκατιδών...

Të parathënëshnin Mister tue par që
noti Profiti, o Zoti Krisht, paralaj-
nëroj : O At lipisiar, Ti dëftove fukjin
e dashuris t'ënde e pushtetshmetue dër-
guar Birin t'önt në jetë për shpërblin.

'Επί τὸ πάθος ...

Tue jardhur të vuaje pesimet që të
bijëvet e Adhamit i burojën të pa-
pesuashmit, i thëshie nikjëvet t'atë:
dishiroja të shkoja këto Pashkë ne
ju pse Ati në dërgoi Mua të vetnin
ler, te jata për shpërblin.

Μεταλαμβάνων . . .

Tue narrë piesë te kjelkji bashkë me
dsënësit thoshie, o i Pavdekshën: nga
lëngu i dhris ngë ka t'pi paneta tue
rruar ne ju, përse Mua të vetnin ler
Tata më dërgoi te jeta për shpërblin.
136.

O R T H R O S i t ë I N T I E S _ _ _

Πόμα καινόν...

Dsënësëvet t'atë, o Krisht, thëshie:
një të pir të pathënëshën dua t'pi te
rregjëria bashkë ne ju piestarë të Hjy-
nis t'ine. Pse Mua të vetnin ler Tata
në dërgoi te jeta për shpërblin.

ODHA E III

Τῷ συνδέσμῳ . . .

Të lidhurë ne lidhien e dashurisë Apo-
stojit, të Zotit të gjithësis të kush-
tuarë lan Krishtin t'i laj këmbët të
mira t'i ligjërojën gjithëve pakjien.

'Η τὸ ἄσχετον ...

Dieja e Perëndis që mban ujërat të
sipërmë që ngë nënd't'nbahen në kjiell
e sbut abisset e kjëvarris dejtrat, vë
tsa ujë te ligjeni sa të lanjë, i Zo-
ti, këmbët e shërbëtorëve.

O R T H R O S i të I N T I E S _ _ _ _

Μαθηταῖς . . .

Dsënësuet in'Zot jep një shembërë përunjësie: Aì që vesh kjiellin me njëkulla rrethonet me një nsallë e tue ujur glurin lan kënbët e shërbëtorëvet: Aì që te duart e 'Tij ka frimën e gjithë të klënëvet.

Odha e VI

"Αβυσσος ἐσχάτη . . .

Jan e humb te honi i nëkatëvet e ngë nëndë të duronj në suvalat e këtij dejeti. Si uluriti Jona të Zotit, lurinj u: ndsirënë nga këjë prishie.

Κύριον φωνεῖτε . . .

Më thërrini Zot e Mësues e vërteta U. Jan, Ti thëshie, o Shpëtues; atë herë t'i glini shembërës si ju e pat tek U.

Ῥύπὸν τις . . .

Kush ngë ka ngjolle, ngë i duhet të lanjë kënbët: ju jini të pastrë, o dsënësit t'inë, po jo gjithë: egërsonet pa regullë hovi i njerit ngak ju.

O R T H R O S i të I N T I E S _ _ _ _

K o n d a k j i Τὸν ἄπρον . . .

Me duart e 'tija përdhënësi merr bukën e ato duar ndén fshehurith sa të marrënjë çninin e Atij që e gjeshi me duart e 'tija. E nbeti i paprekshën Judha shërbëtor e përdhënës.

Kjaseni me trënbësirë Triësës mistike të gjithë me shpirtin të pastër e narriën Bukën tue kjëndruar nd'anëzë t'in'Zoti sa t'e shohiën si lan kënbët e dsënësëvet e i fshin me nësallën e të bëjën na si keni par tue u përujur njeri t'jetrit e tue lajtur kënbët njeri t'jetrit.

Kështu urdhuroi Krishti dsënësëvet e 'tij. Po ngë e gjegji Judha, shërbëtori tradhëtar.

TEK E MADHIA DHE E SHEJTE E INTIE
nbas tradhëtës e shkruarë nga Apostojit e nga Vangjeji, Atërat t'anë që bëjën

gjithkjish mirë, na nësuan të përnendi-
ën katrë Mistere: TË LAJTURIT SHEJT ,
DARKËN MISTIKE, vien në thënë të dorë-
zuarit neve e të dreruashnëvet Miste-
rë, PARKALESIN TË FAMESHSHMEN e KRISH-
TIT e t r a d h ë t i n .

Perëndia të të çilit një
herë si ngrisej u ndie kën-
ba, vien të lanjë sonte
kënbët e apostojvet.

Darkë dyfishe: Mbaruan Pa-
shkët e Ligjës.

Mbaronen Pa-
shkët të reja: Gjaku e Kur-
ni të t'in'Zoti.

Lutia: tërbine, pikë gjaku,
o Krisht, rriedhiën nga fa-
kjëja jote si ti parkales
të largonet nortia e kështj-
tu gënjën arnikun.

Çë nbëhi thikësh e shko-
pesh, o gënjështarë, të popul-
lit, sa të mirrëni Kë do të
vdesënjë sa të shpëtonjë je-
tën ?

Paj të pathënëshmes lipisë s'ate, o
Krisht Perëndia jinë, kjina lipisë,
A n i n .

ODHA E VII

Οἱ Παῖδες ἐν Βαβυλῶνι, ...

Djentë te furri i Babilonës ngë kle-
në dëruar nga flaka, po shturë në nes
t'flakës, dhrosistë nga vesa këndojoën
tue thënë: Bekuar je, o Zot, Perëndi
i prindravet t'anë.

Νευσάζων κάραν ...

Tue tundur kriet vete Judha tue nen-
duar të kekjen ç'isht e bën e kërkon
rastin si të dorëzonjë sa t'jet gjë-

kuar, Gjikëtarin, të Zotin i gjithëve,
Perëndin i atravet t'anë.

Μεθ' ὅστις ἐμοῦ ...

Ai që gudson të vënjë dorën e 'tij
ne Mua te tajuri, në mirë nos^tkishë
shkuar kurr diert e gjellës. Kështu
sbëloi tradhëtarin Perëndia i atëravet
t'anë.

ODHA E VIII

Νόμων πατρώων ...

Tue luftuar për ligjët e atëravet,
të lunët djemë pushtijtën nbi urdhuri-
nin i panençën i tiranitë Babilonë e
bashkuarë ne zjarrin ngë bënëshën hi
e këndojën këtë himn i mirë për të
gjithëmëndëmin: o ju vepra lëvdoni e
lartësoni t'ën'Zonë për not monë.

Οἱ δαιτυμόνες ...

Të lunët Apostoj të ftuarë në gosti
të Sionit, dëgjuesë të Fialës vejën
prapa Dëshmerit si kjenkjë. Bashkuarë
ne Krishtin nga i çili ngë klenë kurr
ndajturë, ushkjërë ne të hjynushmen
Fialë ne-hir po ulurijën: T'ën'Zonë po
lëvdoni, o vepra, e lartësoni per not
monë.

Νόμου φιλίας ...

I erruri Judha Iskariot deshi të har-
roj ligjën e nikjësës e kënbët të la-
ra përgatiti për tradhëtën e tue ngrë-
në bukën t'ënde, të hjynushnin Kurn,
ngrëjti thënbrën kundra Teje, o Krisht;
e ngë dijti të këndoje: T'ën'Zonë po
lëvdoni; o vepra, e lartësoni për not
monë.

Ἐδεξιούτο ...

Me të dërejtën i pandëgjegjëshni mir-
rëj Kurnin që na liroi nga nëkata e
gjakun të hjynushën që u derth për
jetën ngë kishë turp t'e pij posa e
kishë shitur ne çnin. Ngë u trëmp

O R T H R O S i të I N T I E S

përpara të ligës e ngë dijti të këndoju:
t'ën'Zonë po lëvdoni edhe të lartëso-
ni për mot nonë.

ODHA E IX

Ξενίας δεσποτικής . . .

Le t'narriëm pjesë, o të besnë, te
Triesa shejte që in'Zot përgatiti
te dhoma e sipërme për nikjüt e që
liron ngë vdekjia tue mbajtur lart
zënbrat t'ona. Nga Fiala e dsun se
atië lart ë Fiala e na e lartësojën.

"Απιτε τοῖς μαθηταῖς ...

Jetsni , i tha Fiala dsënësövet, te
dhoma e sipërmetek e çila mendia nfor-
tsonet e përgatitni Pashkët për ata
të çilëvet u zë e nësonj Misteret të
hjnushnë e ne të pangriðurën Fialë
e të Vërtetës e lartësoni fukjën e
Dhuratës.

O R T H R O S i të I N T I E S _ _ _ _

Δημιουργὸν ὁ Πατὴρ, ...

Atinë para se jetët në lind Mua Die-
ja, Kriues, fillin i udhëvet e 'tija
në vuri për veprat që nanë nistikjisht
nbaronen. Nga natura Fiala e pa kriu-
arë nanë bënëj t'inin zërin e njeriut
që veshë.

Ὡς ἄνθρωπος ὑπάρχω, ...

Si jani njeri në naturë e jo në dukie,
kështu për shkëmbin të naturëvet ë
Perëndie natura njerëzore nua bashkua-
rë. Prandaj në njihëni një KRISHT
te di naturë të përsosura e të bashku-
ara.

e x a p o s t i l a r i o n

TON NIMFONA v.f.85.

për fjalmet "Eni" v.f.31

Σ τ ι χ η ρ ά

Συντρέχει λοιπόν, ... *Hxos B*

Atëherë Sinedhrii i Judhënjëvet nbë-
jidhet sa të japënjë në duar Bëresin
e Krionjësin i gjithësis. Oh, të pa-
ligjë! Oh, të pabesnitë! ata përga-
titen të gjikojën Atë që ka t'vinjë
të gjikonjë e të gjallitë e të vde-
kuritë. Përgatoten të nundojnë Atë
që na shëndosh nga vuajtiet. O i
nëshiruashmi i Madh'in'Zot, e nadhe
ë lipisia jote . Paqe lëvdë !

'Ιούδας ὁ παράνομος ... *Hxos B*

I paligji Judhë që te darka nglati
dorën sa t'njomëj te tajuri ne Tij,
nanë, o i Madh'in'Zot, ndën dorën ne
ligësi sa t'narrënjë 'rrgjëndin .

Ai që deshi të kursej vajtë érësh,
nanë Tij që je i paqnuashëm ngë u
trënp të t'shisëj. Ai që nglati kën-
bët sa t'ishën lajtur, puthi t'ën'Zo-
në sa t'e jipëj në duar të t'paligjë-
vet. I përzonë nga rradha e Apostojvet

e tue shtur tridhiëtë'rrgjënditë, ngë
pa të Ngjallurit t'at të triditshën,
paj të çilit Ti kijna lipisi.

'Ιούδας ὁ δούλος καὶ δόλιος *Hxos B*

Judha shërbëtuar i rren, dsënësi e gë-
njeshtari, niku e i nahkuani u sbëlua
ne të bënat e 'tij, pse si vej ne Mje-
shtrin ai nendoj t'e tradhëtoj. Vej
tue thënë vet vetiu: ka t'e jap te du-
art e arnikjëvet e ata ka t'në japiën
'rrgjëndin të taksur. Pëlen sa u spën-
dua për Mirin e ne gënjën bën të jet
narrë Isuthi. Jep një të puthur e tra-
dhëton Krishtin. Kështu i vetëni i në-
shiruashëmë Mik i njeriut vien kjellur
si kjenjë të jet thertur.

'Ιουδας ὁ προδότης δόλιος ὢν *Myos B'*

Judha tradhëtari tue klënë gënjeshtar ne një të puthur të rren dha t'ën'Zonë Shpëtonjësën t'ënë te duart e të paligjëvet; të Zotin e gjithësis e shiti si një shërbëtuar. Si kjenkji që kjellur t'jet thertur, kështu i vete Kjenkji i t'in'Zoti, i Biri i Atit, i vetëni shunë lipisiar.

d h o k s a ... kje nin ...

" Οὐ ἐκήρυξεν Ἄμυνδον ... *Myos B'*

Kjenkji që kishë paralajnëruar Isaia vien ne-hir të jet thertur e i jep krahët dejevët që e dërsëllojën e fakjien shplakavet. Ngë priret.

Ng'e prier fakjien nga turpi i pushtinavet e vien dënuar ne një vdekje e dhunuashme. Gjithë këto i pafajshni pranon sa t'gjithëve të na japënjë Ngjallien së vdekurish.

për vazhdimin e Akoluthis

"Si dhoksa prepi etj...

v. f. 36 njer në f. 39.

ἁ π ὀ σ τ ι χ α

Σήμερον τὸ κατὰ τοῦ Χριστοῦ

Sot Sinedhrii i kekjë u mbëjoth kundra Krishtit e kundra Atij llojas mendine të kotë: të dorëzojën të Pafajshmin Pilatit sa t'e vrasënjë.

Sot Judha vë te kjafa tërkuzën e paravet tue sbierrë kështu di gjellë, të hjynushmen e të përkohëshnen.

Sot Kaiafa profeton pa dashur se vëjën një njeri të vdesënjë për popullin.

Vërteta Ai jerdhi të vuaj për mëkatët t'ona sa t'na liroj nga robëria e arnikut si i mirë e njeridashës.

Ms. 40 Aì çë ndaj ne mua bukën
ngrëjti thënbrën kundra ne-
je.

Σήμερον ὁ Ιούδας ...

Sot Judha vë mbë nj'anë maskën e da-
shuris për të vapëkjtitë e sbëlon lak-
nin e 'tij për 'rrgjëndin. As përkuj-
deset në për të vapëkjtitë;ngë shet në
vajët érësh e të nëkatruanes. Aì shet
"Mirin" e kjielliës e i shkurton çni-
nin. Rrieth te Judhenjtë e i thot të
paligjëvet:çë në jipëni ju e u ju e
dorëzonjë? Oh,laknia rrgjëndi e tra-
dhëtarit ! Aì shet vistarin për pakë;
shet për sa duan ata çë blen;ngë treg-
ton nbi çninin,po e shet si një robë
çë ka jikur. Isht zakonë të kusarëvet
të shtien margaritarët. Nanì dsënësi
shtie kjenëvet Vistarin të shejt.

Laknia e 'rrgjëndit e bën të sbierë-
një trut kundra të Zotit. Jikiën nga-
rien e kësaj laknie tue uluritur: O
Zot lipisiar,paçe lëvdì !

Ms. 40 Dilëj jashta e shpejt
flisëj kundra neje.

Ὁ τρόπος σου βολιότητος ...

Sjellia jote isht nbushurë ne gënjé-
trë, o Judhë i kekjë . Tue u sëmurr
ne laknin e 'rrgjëndit fitove urrejten
e njeriut. Në ti deje kjosnë,përçë
u vure ne Mësuesin i vapëkësis ?

Në edhé e deje mirë,përçë shet Atë
çë s'ka çnin tue e përdhënë sa t'jet
vrrar? Dridhu diell,vajtë o dhe e i
shkundur ulurij: O Zot i pafajshën,
paçe lëvdì !

Ms; 40. E sosën tue thënë një fi-
alë e ligë kundra neje.

O R T H R O S i t ë I N T I E S

Μηδεις ὦ πιστοι,...

O të besnë, mosnjeri le t'kjaset dar-
kës e t'in'Zoti në ngë isht i brën-
dëshën ! Mosnjeri krejt të kjaset Tri-
esës si Judha ne gënjën. Në vërtetë a
a! tue marrë bukën u pruar kundra Bu-
kës ; Në dukie dsënës, vërteta një vra-
sës. Rron ne Apostojitë e ne Judhënj-
të bën haré. Tue urrejtur puth, tue
puthur shet Atë çu na shpërbleu nga
nahkini, Perëndin e Shpëtuesin i shpi-
rtravet t'anë.

Δόξα . . . και νῦν . . .

Μυσταγωγῶν . . .

Kur te nisteret t'atë "hije" dsënësit
t'atë, o i Madh'in'Zot, i nësojë tue
thënë: o nikjë ruani mos dreja t'ju
ndanjë ngak U. Në U vuanj e ; e bënë
për jetën. Mos nirrëni skëndah. Ngë
jerdha t'isha shërbier, po sa t'shër-
beja e të jipia gjellën t'ime shpër-
blin për jetën. Në ju jini nikjët
t'inë, kërkonin të në glini nua. Kush
do t'jet i pari, kloft i sprasni, i zot,
të jet shërbëtuar. Kjëndroni tek U
152.

O R T H R O S i t ë I N T I E S

sa t'bëni penë, pse U jan dhria e gjel-
lës .

agathën to eksomolojisthe...

t r i s a j i

kondakji v.f. 139

a p o l i s i s v.f. 42

+